



## IN MEMORIAM



**DY VJET PA MIKUN E SHOKUN TONË LUTFI HANKU!**

BASHKIM LAMI

Faqe 3

## IN MEMORIAM



**BULQIZAKËT, DHE JO VETËM, E DONIN DHE E RESPEKTONIN HAMIT KOÇIN**

AZIS KETA

Faqe 10

## VLERËSIMI



**BAFTJAR RUSI NJË EMËR I MADH I DREJTËSISË SHQIPTARE**

Faqe 4

*Propozimi në Akademinë Përkujtimore të organizuar nga Shoqata Atdhetare Kulturore "Bulqiza" dhe Komisioni i Mjekësisë së Akademisë së Shkencave*

## PROF. DR. AHMET KAMBERI FIGURË POLIEDRIKE E MJEKËSISË SHQIPTARE - TË DEKOROHET ME TITULLIN E LARTË "NDERI I KOMBIT"



## KUMTE\$A

Faqe 2

### MJEKU YNË I VEÇANTË

PROF. DR. GAFUR MUKA

## DOSSIER

Faqe 12-13



**Edip Daci, akademisti që nuk ju nënshtrua as fashizmit, as komunizmit**

### SFIDA E NDRYSHIMIT TË IMAZHIT

HALIL RAMA

Gjatë vizitës së para disa muajve në Sofje, kryetarja e Bashkisë Bulqizë, znj. Festime Mjeshtri dhe kryetari i Bashkisë së Mezdrës, z. Ivan Asparuhov, arritën një marrëveshje të rëndësishme për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore për të përfituar nga mbështetja financiare e BE-së.

Financimi i projekteve nga BE-ja ofron një mundësi të jashtëzakonshme, që duhet të shfrytëzohet në mënyrë efektive. Kësisoj, znj. Mjeshtri, e para grua në drejtimin e kësaj

bashkie të këtyre tri dekadave të fundit, synon që Bulqizën, e cila me gjithë resurset e shumta nën e mbitokësore ka trashëguar problematika serioze, ta shndërrojë në bashki model për gjithë qarkun verilindor të Dibrës. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe takimi që numri një i qeverisjes vendore të Bulqizës ka zhvilluar muaj më parë me ambasadorin e Katarit në Shqipëri, Jabor Ali Hussein Al Haçashela Al Dosari, ku nga ky i fundit u shpreh gatishmëria për të kontribuar në zbatimin e projekteve zhvillimore në këtë bashki, duke u fokusuar në realizimin e ndërhyrjeve në fushat prioritare si: shëndetësi, mbrojtje sociale, arsim, turizëm etj..

FAQE 2

*• Prof. Kamberi ishte nga promotorët e Shoqatës së Kardiologjisë të Shqipërisë, të cilën e drejtoj për një periudhë, gjatë së cilës botoi shumë artikuj në revistën e saj dhe duke organizuar disa aktivitete shkencore. Ai si anëtar i Shoqatës Europiane të Kardiologjisë dhe asaj Botërore, gëzonte një reputacion të veçantë dhe mori pjesë në forumet drejtuese të tyre*

Faqe 3

## BULQIZË

Faqe 16

### REVOLUCION TEKNOLOGJIK NË FABRIKËN E PASURIMIT TË KROMIT



## REPORTAZH

Faqe 11

### VIÇISHT, FESTË NË FSHATIN E MARTIRIZUAR

## HISTORIA

Faqe 14

### KËNGA E DIBRËS KUNDËR HAJREDIN PASHËS, MBLEDHUR NGA HAKI STËRMILLI

## LETRAT

Faqe 15

### ELEGJI PËR MEHMET DURIÇIN

DR. ADRIATIK BALLA

## KAMPIONI

Faqe 14

### RIKTHIM PAS 6 VITESH ME FITORE I "TAJSONIT SHQIPTAR" GJETAN KETA



Në një vit të drejtimit nga kryebashkiakja Festime Mjeshtri bashkia e Bulqizës ka shënuar progres të dukshëm

aktualitet

# Sfida e ndryshimit të imazhit



HALIL RAMA

## HALIL RAMA – MJESHTRË I MADH

(vijon nga fq. 1)

**K**y bashkëpunim me kreun e Bashkisë së Mezdrës, z. Ivan Asparuhov si dhe me ambasadorin e Katarit në Shqipëri, Jabor Ali Hussein Al Hashwela Al Dosari bazohet, në faktin se në një vit të drejtimit të Bulqizës nga kryebashkiakja Mjeshtri e vlerësojnë këtë bashki si model, madje duke e cilësuar Bulqizën si një histori suksesi.

Në të vërtetë, kthesa e shënuar që nga korriku i vitit të kaluar (pas skandaleve e historive korruptive të paraardhësve të saj) dëshmon para së gjithash rritjen e performancës dhe besueshmërisë së administratës të Bashkisë.

Ballafaqimi me premtimet e para një viti nxjerr në pah jo vetëm përbushjen e tyre, por edhe tregues të tjerë që kanë të bëjnë me parametra bashkëkohorë të një bashkie në rritje e zhvillim intensiv. Nëse deri para një viti, shumë nga përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare e shihnin me skepticizëm bashkëpunimin me Bashkinë e Bulqizës, kjo vinte nga prapambetja e trashëguar, sidomos në infrastrukturën e vetë bashkisë. Që të fitohej besimi reciprok, duhej nisur pothuajse nga e para.

Sfida kryesore mbeteshin burimet njerëzore. Kryetarja e Bashkisë, Festime Mjeshtri, pikërisht këtë sfidë po e përballon me dinjitet, duke ndërtuar një administratë të aftë profesionalisht dhe të përkushtuar, për ta bërë Bashkinë e Bulqizës (dhe jo vetëm qytetin minator) të standardeve të përparuara. Kryerja e analizave me përgjegjësi, identifikimi në kohë i problematikave dhe përcaktimi i rrugëzgjdhjeve efikase sollën që në vitin e parë të mandatit të saj ndryshimin e kërkuar. Kështu gjatë vitit të fundit, Bashkia Bulqizë ka ndërmarrë një sërë projektesh të rëndësishme në fusha të ndryshme, duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët.

Është investuar në infrastrukturë, mjedis, shërbime sociale, arsim dhe sektorë të tjerë kyç. "Sigurisht, kemi ende shumë për të bërë dhe projekte të tjera janë planifikuar për t'u implementuar në të ardhmen. Shumë nga këto projekte do të zhvillohen pas konsultimeve me komunitetin për të vlerësuar prioritetet", – shpreh kryebashkiakja Meshtri.

Parë nga një këndvështrim i përgjithshëm, arritjet janë evidente në infrastrukturë, në rrjetin e kanalizimeve dhe ndriçimin, në përmirësimin e mjedisit, shërbime sociale e arsim. Evidente janë edhe projektet me donatorët e huaj. Kjo, falë drejtimit me kompetencë e përkushtim nga Festime Mjeshtri që nga 23 maji



2023. E diplomuar në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, dega "Infermieri", ajo ka bërë emër fillimisht si specialiste Promocioni në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Bulqizë, për rreth 10 vjet, ndërkohë që në vitin 2022 ajo mori detyrën si drejtoresh e Spitalit të Bulqizës. Gjatë kësaj periudhe, Mjeshtri ka kryer shumë trajnime në fushën e shëndetësisë. Gjithashtu ajo ka punuar si mësuese me kohë të pjesshme në shkollën "Qendra e Formimit dhe Arsimit Profesional", në qytetin e Bulqizës. Përvoja si specialiste dhe drejtuese në institucione të rëndësishme i ka shërbyer dhe i shërben për të përballuar sfidën e ndryshimit të imazhit. Dhe jo vetëm të Bulqizës-qtet minator si Njësia Administrative Qendër, por edhe të shtatë njësive administrative ish-komuna, si Martaneshi, Fushë-Bulqiza, Zerqani, Shupenza, Gjorica, Ostreni e Trebishti malor, me 63 fshatra të shtrirë në një sipërfaqe prej 678.52 km katrorë.

## POZITA GJEOGRAFIKE, POPULLSIA DHE RESURSET MBI E NËNTOKËSORE

Bulqiza kufizohet në veri me Bashkinë e Dibrës, në perëndim me Bashkinë Klos, në jugperëndim me Bashkinë Tiranë, në jug me Bashkinë Librazhd dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bulqizës. Sipas Censit të vitit 2011, ka një popullsi prej 32,210 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 40,223 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 678.51 km<sup>2</sup> me një densitet prej 59.28 banorë/km<sup>2</sup> sipas Regjistrat Civil dhe 47.47 banorë/km<sup>2</sup> sipas censit 2011.

Popullsia e Bulqizës është në shumicë dërmuese e besimit mysliman dhe një pakicë fare e vogël u përket besimeve të tjera. Relievi kodrinor-malor përcakton si burime kryesore

Nëse deri para një viti, shumë nga përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare e shihnin me skepticizëm bashkëpunimin me Bashkinë e Bulqizës, kjo vinte nga prapambetja e trashëguar, sidomos në infrastrukturën e vetë bashkisë. Që të fitohej besimi reciprok duhej nisur pothuajse nga e para. Sfida kryesore mbeteshin burimet njerëzore. Kryetarja e Bashkisë, Festime Mjeshtri, pikërisht këtë sfidë po e përballon me dinjitet, duke ndërtuar një administratë të aftë profesionalisht dhe të përkushtuar, për ta bërë bashkinë e Bulqizës (dhe jo vetëm qytetin minator) të standardeve të përparuara



## MJEDISI – SYNOHET MBJELLJA E 3000 FIDANËVE PISHË E ZEZË

Mjedisi konsiderohet nga kryebashkiakja Mjeshtri një tjetër sektor me rëndësi të veçantë. Për këtë janë organizuar aksione të vazhdueshme për pastrimin e zonave të ndryshme, duke përfshirë qytetarët, kryesisht të rinjtë, për të rritur ndërgjegjësimin dhe përfshirjen në ruajtjen e hapësirave publike. Po ashtu, me mbështetjen e organizatave lokale ka nisur mbjellja e mbi 3000 fidanëve pishë të zeza në kuadër të vitit shqiptar të pyjeve. Janë shtuar dhe 100 kosha të rinj për mbledhjen e mbetjeve në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

## SHËRBIM I SPECIALIZUAR PËR FËMIJË E TË RINJ ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Në fushën e shërbimeve sociale është firmosur një marrëveshje bashkëpunimi mes Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkisë Bulqizë për zbatimin e projektit "Shërbimi i specializuar për fëmijë e të rinj me aftësi të kufizuara në familje dhe në Qendrën Ditore në Bashkinë Bulqizë" mbështetur financiarisht nga programi i Fondit Social. Përmes këtij projekti bëhet e mundur zgjerimi i shërbimeve sociale në 8 Njësitë Administrative të Bashkisë Bulqizë. Bashkia Bulqizë do të ofrojë shërbime të specializuara në familje dhe në Qendrën Ditore për fëmijë dhe të rinjtë me aftësi ndryshe. Ata do të përfitojnë rregullisht shërbime mbështetëse psiko-sociale, terapeutike, etj., duke u dhënë mundësinë të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë.

## BIBLIOTEKA DHE KLASA INTELIGJENTE NË SHKOLLAT E BULQIZËS

Në sektorin e arsimit, Bashkia Bulqizë ka ndërmarrë punime për riparimin dhe përmirësimin e objekteve arsimore, përfshirë restaurim, lysterje dhe përmirësim të rrjeteve hidraulike dhe sanitare. Gjithashtu, po investohet për pasurimin e shkollave me biblioteka dhe klasa inteligjente. Për shembull, gjimnazi "Rifat Manjani" në Shupenzë ka tashmë një bibliotekë të re dhe një klasë burimore të pajisur me bazën materiale didaktike dhe mobilimin e nevojshëm për zhvillimin e planeve specifike në ndihmë të fëmijëve me aftësi ndryshe.

## PËRMIRËSIME NË RRJETIN E KANALIZIMEVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Në qytetin e Bulqizës janë bërë përmirësime të ndryshme në sistemet

(Vijon në faqen 3)



# in memoriam

## Dy vjet pa mikun e shokun tonë **Lutfi Hanku!**

**BASHKIM LAMI**

Dy vjet më parë ( me dt 15 prill 2022) iu dha lamtumira e fundit për rrugëtimin e shpirtit të tij në parajsën e merituar shokut e mikut tonë Lutfiut, i cili kohët e fundit u mundua nga sëmundja deri sa ndaloj rrahjet zemra e tij, duke na hidhëruar, por jeta e tij ishte e mbushur me dashuri e aktivitete si rrallëkush për të mos u harruar.

Lutfi Hanku lindi në Zerqan të Dibrës më 1933 nga një familje e mesme, patriotike me besim bektashian. Babai i tij Sabriu dhe e ëma vdiqën të rinj dhe Lutfiu u rrit jetim në gjirin e familjes patriotike "Hanku". Mësimet e para i mbaroi në vendlindje. U aktivizua si pionier në luftën kundër pushtuesit italo-gjerman. Mbas çlirimit të atdheut vazhdoi studimet në Normale të Elbasanit dhe Uniken në Peshkopi. Më 1948-1952 ndoqi shkollën pedagogjike në Peshkopi bashkë me 16 moshatarë të tij dhe vitin e fundit të pedagogjikes e mbaroi në Shkodër.

E filloi punën me përkushtim si mësues në shkollën 7-vjeçare të sapokrijuar për punëtorët në Bulqizë, më pas vazhdoi në Kastriot, në Zerqan dhe në pak kohë si inspektor arsimit. Më 1956-1960 mbaroi Universitetin Shtetëror të Tiranës, fakultetin Histori-Filologji. Nga viti 1960-1992, mësues i gjuhës shqipe në shkollat e mesme të qytetit të Peshkopisë, ku nuk u shkëput për asnjë çast nga detyra e nderuar e mësuesit nga viti 1960 deri në vitin 1992, duke punuar shumë vite në Shkollën Pedagogjike dhe atë bujqësore, më pas në shkollën e mesme të përgjithshme derisa doli në pension. Lutfiu ndjente kënaqësi kur në rrugë e ndalonin mjaft njerëz dhe e përshëndesnin duke i thënë me shumë dashuri e respekt: "Profesor, kemi qënë nxënësit e tu. Kështu i ka ndodhur dhe me emra të njohur si Shaban Sinani, Lirie Rasha, Naim Çorja, Lavdrim Shehu e Gjëlosh

Gjoni, etj. Ai i kujtonte me shumë dashuri e respekt të gjithë shokët e kolegët e tij në vite dhe në biseda tregonte episode të bukura të bashkëpunimit ku shpaloste me shumë dashuri vlerat më positive të tyre, si pjesë e pandarë e jetës. Lutfi Hanku, ishte dhe mbeti deri në fund të jetës praktikant e besimtar i devotshëm dhe përhapës i besimit të paqtë bektashian. Në veprat e tij letrare e publicistike, bektashizmi, zë një vend të rëndësishëm.

Lutfiu ishte mësues i talentuar në klasë dhe ka drejtuar rrethet letrare të shkollave, bibliotekat dhe aktivitetet shkencore, kulturore artistike. Është vlerësuar në konkurimet kombëtare për drama, ansamble artistike dhe estrada me medalje nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës.

Botimet e para nisin qysh në vitin 1953, atëherë sapo kishte dalë nga bangat e Shkollës Pedagogjike. Që në vitet '60 ka botuar në shtypin monist përshkrime, skica letrare, tregime, monografi të shkurtra historiko-letrare në përmbledhje me shumë autorë dhe në gazeta e revista të sistemit monist dhe pluralist. Ka drejtuar ca kohë gazetën "Dibra" ku ka bashkëpunuar me gazetarët Velo Cfarku, Fatos Daci, Kamber Farruku, Garip Troci, etj. Në TVSH janë shfaqur tre telefilma për heronjtë e Dibrës.

Lutfi Hanku nuk mund të qëndronte vetëm brenda për brenda kornizave të klasave, aty ku jepte mësim. Shpirti i tij prej krijuesi premtonte për më shumë.

E sot janë me dhjetëra monografi të shkurtra historiko-letrare të botuara, por edhe të trasmetuara në radio, tre skenarë për dokumentarë për heronjtë e Dibrës janë shfaqur në ekranin e televizionit shtetëror, por megjithatë Lutfiu e ndiqte nga pas kudo një "hije" që i pati lënduar shpirtin, por ai kurrë nuk u dorëzua. Punoj fort në rrugën e krijtarisë dhe i ka dhënë lexuesve libra me vlera, ku del në pah stili i tij i veçantë me përshkrime brilante të personazheve realë të historisë e të



jetës plot brenga e sakrifica. Forca krijuese, gjuha mjaft e pasur që përdor, faktet, kronikat dhe legjendat e bëjnë prozën e Lutfi Hankut më të pranueshme për lexuesin e gjerë shqiptar.

Lutfi Hanku me krijimtarinë e tij botoi më 1974 "Nëpër gjurmët e heroit" dhe më 1980 e ribotoi me titullin "Nazmi Rushiti". Në vitin 2000 botoi librin "Kaçaku", më 2003 "Drita e shpirtit". Më 2006 romanin "Erdhi Caushi", më 2009 "Marsi i vrarë" (vepër historiko-letrare). Është gjithashtu redaktor në shumë libra të krijuesve dibranë dhe i artikujve të shumtë në gazeta e revista si tek "Rruga e Arbërit", "Gazeta

Bulqiza", "Drita", "Nëntori", Ushtima e Maleve", "Gazeta Dibra", etj.

Lutfi Hanku ka qënë qysh më 1975, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Ai është dekoruar dy herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, vlerësuar tri herë me dëshminë "Mirënjohja e kombit", vlerësuar nga Këshilli Bashkisë Bulqizë "Qytetar Nderi".

Në vitin 1991 Lutfiu mbeshteti pa rezerva ndryshimet demokratike në qytetin e Peshkopisë ku jetonte dhe dha kontributin e tij në bashkëpunim me koleget Safet Zhulali, Spartak Topollaj, Mirush Mati, Bexhet Shehu, Gjyzel Hasani, Kamber Farruku, etj. Me krijimin në vitin 2015 të "Shoqatës Bulqiza" Lutfi Hanku u zgjodh President i kësaj shoqate ku për kontributin e tij të çmuar për aktivitetet e shoqatës dhe për ecurinë e botimit të gazetës "Bulqiza" profesor Lutfiu është nderuar me titullin "Nderi i Shoqatës Bulqiza". Lutfi Hanku kudo punoj e jetoj me urtësi e dashuri që nuk do ta harrojmë.

Lutfiu ishte krenar për familjen e tij, për dy vajzat mësuese Kozeta dhe Amarda, për nipërit e mbesat, që i qëndruan pranë dhe e mbështetën me shumë dashuri në jetën e tij modeste në Peshkopi dhe në Tiranë. Sëmundja dhe problemet e moshës e munduan Lutfiun, që na mungoi në tavolina e aktivitete këto dy vitet e fundit, por urtësinë e mençurinë e tij nuk do ta harrojmë.

Ndarja e tij nga jeta ishte një humbje e madhe për familjen, të afërmit e shokët e tij të shumtë. Kryesia e "Shoqatës Bulqiza" do organizojë në vijimësi akademi përkujtimore kushtuar këti dishepulli të dijes, këtij personaliteti të ndritur të arsimit, letrave dhe kulturës! Sepse puna dhe vepra e tij mbeten të paharruara në mendjet dhe zemrat e të gjithë atyre që e njohën e punuan me këtë njeri që do të na mungojë por që do ta kujtojmë me shumë dashuri e respekt dhe nuk do ta harrojmë.

## Sfida e ndryshimit të imazhit

(Vijon nga faqja2)

e kanalizimeve dhe ndriçimit publik. Është rehabilituar rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ujërave të bardha. Gjithashtu, kanë nisur punimet për rregullimin e rrugëve dhe trotuareve, duke përfshirë sinjalistikën horizontale për të rregulluar qarkullimin rrugor dhe për të siguruar një ambient të sigurt për të gjithë përdoruesit e rrugës. Një tjetër projekt i rëndësishëm është rikonstrukcioni i një blloku pallatesh në qytetin e Bulqizës.

Ky projekt përfshin ndërhyrje në fasadat e pallateve dhe veshjen e tyre me sistemin kapot. Rikonstrukcioni do të ndihmojë në izolimin termik të objekteve, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe duke reduktuar konsumin e energjisë për ngrohjen e ambienteve. Gjatë muajve të verës punohet intensivisht edhe për rehabilitimin dhe sistemimin e kanaleve kulluese në ndihmë të banorëve/ fermerëve me prodhimin bujqësor.

**PROJEKTE NGA DONATORËT E  
HUAJ**

Me financimin nga Ndihma Bullgare për Zhvillim ka nisur implementimi i projektit "Rritja e kapaciteteve të punonjësve dhe njërive administrative të Bashkisë Bulqizë për agro-turizmin dhe turizmin malor".

Kryetarja e bashkisë, Festime Mjeshtri, shprehet se ky projekt synon promovimin e turizmit, i cili është kyç për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë lokale dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Po ashtu, nga janari i vitit 2023, Terre des Hommes dhe UNICEF Albania, me mbështetjen financiare të qeverisë Britanike, po implementojnë projektin "Ngritja e rezistencës parandaluese dhe shërbimet e reagimit të menjëhershëm për fëmijët viktimë të trafikimit dhe formave të rënda të dhunës" në Bashkinë Bulqizë.

Gjithashtu, me mbështetjen e qeverisë britanike, do të shtri-

jnë shërbimet komunitare edhe në Njësinë Administrative Shupenzë, me qëllim ofrimin e shërbimeve cilësore për të gjithë komunitetin, familjet dhe individët në nevojë. Me mbështetjen e donatorëve ndërkombehtarë, Bashkia Bulqizë ka sot një Qendër Komunitare Multifunksionale. Përmes mbështetjes së projekteve të financuara nga Bashkimi Europian, kemi realizuar një sërë aktiviteteve edhe me të rinjtë në fushën e sportit.

Të gjitha këto arritje, që e rendisin Bashkinë e Bulqizës ndër më të mirat në rang vendi, padyshim që i dedikohen kryebashkiakes Mjeshtri.

Në një vit të drejtimit të kësaj bashkie, ajo ka shfaqur aftësi të shkëlqyera organizative, marrëdhënie korrekte me qytetarët dhe bashkëpunim ndërinstytucional në mjaft efektiv, në funksion të përmbyshjes së angazhimit për ta bërë bashkinë e Bulqizës, ndër më konkurrueset me simotrat e saj



Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet dhe partnerët e tij ndërkombëtarë Amerikanë dekoron një emër të madh në radhët e drejtësisë shqiptare

# AVOKAT BAFTJAR RUSI, "Misionar i paqes botërore"

**I vlerësuar me titujt "Misionar i Paqes Botërore", "Ambasador Nderi", si dhe me Medaljen e Artë "Urdheri i Misionarit të Paqes Mahatma Gandhi", Baftjar Rusi qëndron stoik në vitalitetin e dibranit, njeriut me vlera të larta morale të integruar në jetën moderne, të një njeriu që shpreh pa droje pozicionin e tij të pandarë nga historia jonë e përbashkët e një tranzicioni social - psikologjik ende të pambyllur**

Në fund të viteve 80, kur sapo ishte diplomuar për gjuhë-letërsi, erdhi që nga Saranda mësuës në gjimnazin e Bulqizës, publicisti dhe prozatori Shefki Hysa. Këtu, të parët që do ta mbështesnin mësuësin jabanxhi, qenë vëllezërit nga Homeshi, Demir e Baftjar Rusi, njëri shëf i Shtëpisë së Ushtrakeve Bulqizë dhe tjetri sekretar i Komitetit të Rinisë të rrethit Dibër. Dy vëllezërit që kishin bërë emër edhe si gazetarë e poetë, mbështetjen për Shefkiun e patën të pakushtëzuar e të pakursyer edhe për faktin se me reportazhet e tij në "ZP" e "Zëri i Rinisë", sarandiotti i miqësuar shumë shpejt me bulqizakët pasqyrore me të miri jetën dhe problematikën e qytetit minator të Bulqizës. Dhe kjo miqësi e pandarë midis tyre do të farkëtohej në vite e dekada, kur të tre, Shefkiu, Demiri dhe Baftjari bënë emër edhe në metropolin shqiptar, jo vetëm si poetë, publicistë e prozatorë por edhe në profesionet e tyre të mirëfillta.

I vendosa këto radhë si hyrje për të mbritur te ngjarja kulmore e miqësisë së tyre. Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet dhe partnerët e tij ndërkombëtarë Amerikanë - një institucion prestigjioz ndërkombëtar ky me Presidentin Shefki Hysën, nderoi avokatin e mirënjohur Baftjar Rusi me titujt "Misionar i Paqes Botërore", "Ambasador Nderi", si dhe me Medaljen e Artë "Urdheri i Misionarit të Paqes Mahatma Gandhi".

## DY ISH KRYETARË TË KUSHTETUESËS VLERËSOJNË KARRIERËN E SHKËLQYER TE BAFTJAR RUSIT

Në ceremoninë e organizuar nga Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet dhe partnerët e tij ndërkombëtarë, ku merrte pjesë dhe Dr. Madhu Krishan, të shtunën më 11 maj 2024, personaliteti i Drejtësisë Shqiptare, Dr. Baftjar Rusi u vlerësua me motivacionin: "Për angazhimin e madh dhe kontributin e çmuar në fushën e Jurisprudencës, Arsimit, Qytetërimit, Politikës, Administratës Publike, Paqes, Prosperitetit dhe Njerëzimit, për frymëzimin e bashkëjetesës shoqërore dhe paqes ndërkombëtare".

Ky vlersim është plotësisht i motivuar për Baftjar Rusin si: Avokat i Suksesshëm Shqiptar; si Doktor i Shkencave në Jurisprudencë; si autor i librave dhe artikujve kërkimor në fushën e Drejtësisë, të Shëndetit të Jetës, Shëndetit Mendor dhe Shkencave Juridike; si Pedagog mësimdhënës; si Avokat Përfaqësues në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut; si Avokat në Gjykatën e Strasburgut dhe Gjykatën Ndërkombëtare Penale në Hagë; si personalitet i nderuar me shumë çmime kombëtare dhe Ndërkombëtare; si Misionar i Paqes Botërore; si Aktivist i Njohur i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut; si filantrop dhe Ambasador Nderi i DMPP; si Promovues i Misioneve të Ardhsme që sjellin Paqen dhe Prosperitetin për

mbarë Njerëzimin etj.

Këto merita të Baftjar Rusit marrin vlerën dhe dimensionin e duhur kua në një event të rëndësishëm si ky evidentohen edhe nga personalitete të njohura të jurisprudencës, si nga dy kryetarët e Gjykatës Kushtetuese Fehmi Abdiu e Bashkim Dedja, nga kryetarja e bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri, apo dhe nga Prof. Dr. Sulejman Abazi NESHA.

Bashkim Dedja, një ndër përfaqësuesit më dinjtozë të elitës dibrane në metropolin shqiptar e më gjerë, që i ka ngjitur me meritë shkallët e karrierës deri në krye të institucionit më të lartë të drejtësisë shqiptare, vlerëson se për Z. Baftjar Rusi, nuk do mjaftonin artikuj, emisione televizive apo seri romanesh, për të nxjerrë në pah të gjithë vlerat e tij shumëdimensionale.

"E vlerësoj shumë, në radhë të parë si një prind e familjar i mirë e i përkushtuar; si një shok e mik i rrallë e me vlera të padiskutueshme; si një profesionist drejtësisë i pregtitur e këmbëngulës i pasqorë në arritjen e rezultateve; si një bamirës e filantrop që rrallë e gjen në realitetin shqiptar, si një studiues e akademik në ngritjen e nivelit të tij profesional e intelektual dhe në përcimin e dijeve e njohurive të tij tek të tjerët, si një bashkëpunëtor e bashkëbisedues i palodhur me një durim deri në ekstrem, që i bën nder dhe krenari vendlindës së tij, Dibrës, Shqipërisë dhe shqiptarëve kudo që ndodhen e kujtdo që i ndodhet pranë", shprehet Z. Dedja.

## BAFTJAR RUSI NJË EMËR I MADH NË RADHËN E DREJTËSISË SHQIPTARE

Prof. Dr. Sulejman Abazi NESHA - Doctor Honosis Causa për Sigurinë dhe Paqen, Profesor Nderi i ABP dhe UBP, Nev York, që mban Medaljen e Artë "Gjenerali Paqes Ajzenhauer" në fillim të fjalës së tij u shpreh mirënjohje Guvernatorit Dr. Shefki Hysa, dhe Dr. Madhu Krishan për zgjedhjen më të mirë për të akorduar këtë titull kaq të lartë Ndërkombëtar, duke e dhënë për herë të parë në Shqipëri, pikërisht njeriut të merituar, dibranit dhe shqiptarit të mirë, Dr. Baftjar Rusi. Sepse personaliteti i tij është një vlerë e shtuar e Misionit Diplomatik për Paqe e Zhvillim, e Korpusit të Madh të Njerëzve të Paqes në Botë, e atyre njerëzve që jetën e tyre ia



kanë përkushtuar Drejtësisë, Lirisë, Paqes dhe Humanizmit njerëzor.

Ndryshe nga disa prezantime tashmë tradicionale në ceremonitë e dekorimeve të DMPP-së, Prof. Dr. Sulejman Abazi NESHA, këtë herë prezantoi para këtij auditori të jashtëzakonshëm një trajtim disi më ndryshe në shpalosjen e vlerave të një personaliteti, të një burri dibran, një shqiptari të mirë, që si shumë të tjerë në këtë vend, përballoi gjithçka që shkarkoi presionin i kohës së ndryshimeve mbi brezin dhe brezat me vështrimin nga jeta, liria dhe shpresa. Ai e konsideoi Baftjar Rusin një emër të madh në radhët e drejtësisë shqiptare, në fushën e Avokatisë.

Në një radhitje dhe rendje plotë merita e modesti, e cila na kujton se kemi shumë për të bërë dhe për të promovuar me merita të plota personalitete të veçantë të jetës shqiptare, prof. Sulejman Abazi NESHA nënvizoi vendosmërinë intelektuale që e ka shoqëruar personalitetin e Baftjarit nga mosha e re e deri më sot. Ai vjen në realitetin e kohës, duke pasur mbi supet e tij peshën e viteve të punës dhe të profesionit të vështirë.


"Përtej të zakonshmes, Doktor i Shkencave të Jurisprudencës shqiptare tashmë si një jurist - avokat me kulturë të ndërthurur evropiane, kaloi në rrugën e vështirë të aktivitetit shoqëror dhe politik në qarkun e Dibrës, të arsimit dhe kualifikimit në Universitetin e Tiranës, dhe më tej si mësimdhënës, për t'u vendosur përfundimisht në Tiranë pa shkëputur asnjëherë lidhjet me vendlindjen. Nga viti 1995 e deri më sot, vazhdon të ushtrojë profesionin e Avokatit të dëgjuar dhe respektuar në Shqipëri. Autor i botimit "Mbi të Drejtën" ai ka treguar se është një studiues dhe mik i shtrenjtë për librin, duke rritur cilësinë e tij profesionale përmes mbrojtjes së qindra çështjeve për vepra penale e civile deri në gjykatat Ndërkombëtare në Hagë dhe Strasburg. Një rrugëtimin sfidant përmes shumë vështirësive për të arritur majat, ku përveç seriozitetit, drejtësisë

dhe ashpërsisë së profesionit ai ka gjetur rrugën e reflektimit të dashurisë njerëzore, larg urrejtjes, i mbështetur në optimizmin karakteristik të njerëzve të fortë, që jeta u ka mësuar të bëhen pjesë e të mirës dhe të distancohen nga ligësia, hipokrizia, duke formuar gradualisht një anë të tjerë të karakterit dhe personalitetit të tij, shpirtin human dhe paqësor", dha ndër të tjera Prof. Sulejman Abazi NESHA. Kjo, sepsë këtë anë të karakterit të tij Baftjari e shfaqti në punë, por e shfaqti edhe në familje, si një prind shëmbullor, shok e bashkëshort i mirë, mik i madh i njerëzve të afërt dhe kolegëve me një status të qëndrueshëm intelektual në standardet evropiane. Më tej Prof. Sulejman Abazi NESHA evidentoi mendimet dhe vlerësimet për avokatin Rusi, të këtij dibrani me botë të madhe, që rrokkin një dimension të gjerë, dhe këtë e kupton kur je afër dhe bashkëbisedon me të.

## MISHËRUES DHE PËRÇUES I VLERAVE MË TË MIRA NJERËZORE DHE INTELLEKTUALE

Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet dhe partnerët e tij ndërkombëtarë ka të drejtë në këtë vlerësim për Njeriun patriot që e do shumë atdheun e tij Dibrën dhe Shqipërinë, që shfaqet me tabanin popullor, duke reflektuar fisnikërinë e origjinës prindërore, të njeriut modern dhe të civilizuar, juristin dhe avokatin e vendosur për të mbrojtur dhe për të dhënë drejtësi njerëzve të shantazhuar nga struktura konjukturale të drejtësisë.

Drejtësia në thellësi të shpirtit të tij njerëzor dhe human reflektonte siguri, paqe dhe mbështetje, kundër komplekseve dhe paragjykimeve të jetës tonë të traumatizuar nga pasojat e kohës. Është kjo drejtësi e thellë brenda shpirtit të Avokatit, që kërkon në vijimësi zgjimin dhe rizgjimin e energjive pozitive për të përcjellë në opinion një mesazh shprese dhe rilindje të vërtetë morale e shpirtërore.



Po, po, të gjithë e ndjejmë se kemi shumë nevojë për këtë. Brenda një portreti të thjeshtë në pamje por shumë vital në vullnetin e tij të imponimit, komunikimit, të njohjes dhe të sjelljes, të vendimarrjes mbi drejtësinë, shpaloset figura humane e paqësore e Dr. Baftjar Rusit.

Luftëtari kundër së keqes që po vazhdon të dhunojë dhe trishtojë jetën tonë, kundër padijes dhe korrupsionit, kundër pangopësisë dhe politikës memece kur është fjala për drejtësinë e munguar, ky realiteti i dhimbshëm është objekt i qëndrimit të palëkundur të Avokatit të Nderuar, kundër klaneve, ndërhyrjeve, presioneve, anatamimeve për shkak të konfliktit të interesave, për ta bërë atë pjesë të drejtësisë së munguar dhe të padrejtësisë. Nuk ia kanë dalë.

Shokët, miqtë dhe kolegët e tij tregojnë: Nëse do të jesh në bisedë me Baftjarin, do të kuptosh menjëherë se në mendimet e tij dallon vlerësimi për jetën e njeriut të dominuar përherë nga barbaria, kaosi, dhuna, por dhe mirësia dhe dashuria. Gjithmonë kundër së keqes do të gjendjen hapësira për t'i dhënë formë shpresës.

Kur flet me të, - vijoi Prof. Dr. Sulejman Abazi NESHA, të krijohen imazhe të qarta mbi atë që ai mendon për traditat, realitetin e sotëm dhe pasojat e një ndryshimi të vonuar. Ai të jep përshtypjen e një interlokutori të pandalshëm midis vlerave të jetës në një pafundësi ngjarjesh si një vajtje - ardhje që të mban afër dhe të lidhur me realitetin që përjetojmë.

Ai mbetet si gjithmonë fisnik dhe i freskët në mendime, siç mund ta keni njohur në ditën e parë të miqësisë me të. Ai qëndron stoik në vitalitetin e dibranit, njeriut me vlera të larta morale të integruar në jetën moderne, të një njeriu që shpreh pa droje pozicionin e tij të pandarë nga historia jonë e përbashkët e një tranzicioni social - psikologjik ende të pambyllur.

Ky është personaliteti i njeriut që duam, që aq shumë e dëshirojmë në majat e drejtimit të piramidës së shtetit dhe të shoqërisë. Larg kompleksitetit të jetës, Avokati ynë i Nderuar shpalos ndjenjat e larta të humanizmit dhe të mirësisë njerëzore, në përballje me sfidat e jetës, duke mos harruar kurrë se i mjafton të ndihet qetë në vetëdijen e tij kur përfshihet me kurajo në realizimin e gjërave të vogla, por me dashuri të madhe. Kjo është tipikja e personalitetit të Shenjtësisë së saj Nënë Terezës Shqiptare. Këtë ka marrë përsipër të bëjë krenaria e Dibrës, miku dhe shoku ynë i mrekullueshëm, Dr. Baftjar Rusi. Ai ka marrë shumë lëvdata dhe dekorime gjatë jetës dhe karrierës së tij, nga institucione dhe organizata e organizma kombëtare dhe ndërkombëtare, por titujt "Misionar i Paqes Botërore", "Ambasador Nderi", si dhe Medalja e Artë "Urdheri i Misionarit të Paqes Mahatma Gandhi" e vndosin në hierarkinë e personaliteteve më me vlerë të kombit shqiptar.

Personalitete të njohura të avokatisë si Baftjar Rusi kanë si lajmotiv dhënien sa më shumë lumturi të tjerëve. Ai, ka qenë gjithmonë dhe është një prijës i së mirës shoqërore, i së mirës së përbashkët, një talent në fushën e jurisprudencës, që e kalon stekën e kohës. Baftjar Rusi është modeli i njeriut fisnik, autoritar, të ciltër, të dashur, bashkëpunues dhe të gjindshëm në çdo vështirësi. Si mishërues i urtësisë dhe mençurisë dibrane ai kudo dhe kurdohet përçon vlerat më të spikatura njerëzore dhe intelektuale.



# Prof. Dr. Ahmet Kamberi të dekorohet me titullin e lartë "Nderi i Kombit"

• Prof. Kamberi ishte nga promotorët e Shoqatës së Kardiologjisë të Shqipërisë, të cilën e drejtoj për një periudhë, gjatë së cilës botoi shumë artikuj në revistën e saj dhe duke organizuar disa aktivitete shkencore. Ai si anëtar i Shoqatës Europiane të Kardiologjisë dhe asaj Botërore, gëzonte një reputacion të veçantë dhe mori pjesë në forumet drejtuese të tyre

## NGA BASHKIM LAMI\*

"Shoqata Atdhetare Kulturore Bulqiza" në bashkëpunim me "Komisionin e Mjekësisë" të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë organizuan më 6 prill 2024, ora 11.00 në sallën "Aleks Buda" e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. "Akademi përkujtimore" në nderim të prof. dr. Ahmet Kamberit, një prej personaliteteve të mjekësisë shqiptare, i ndarë nga jeta në tetor 2023.

Një komision i posaçëm me Genc Sulçebe, Bashkim Lami, Gafurr Muka, Selman Dumani, Enver Hysa, folësat, familjarë e miq të doktor Ahmetit bënë përgatitjet e duhura deri në finalizimin e këtij eventi përkujtimor.

Të gjithë folësit, autorët e kumtesave, sollën në vëmendje të të pranishmëve rolin e jashtëzakonshëm të Ahmet Kamberit në mjekësinë shqiptare, sidomos në kardiologji, por edhe kontributin e tij shoqëror e shtetëror, si kadri shkencor e politik që kanalizoi kardiologjinë shqiptare mbi baza shkencore bashkëkohore. Ai u shqua si mjek inovator, humanist, i dashur me kolegët, studentët dhe pacientët; duke patur një kontribut tërësor 62-vjeçar në mjekësinë shqiptare.

Fjalën e hapjes e mbajti presidenti i shoqatës "Bulqiza", prof. asc.dr. Islam Dauti, sot profesor në Universitetin mjekësor, i cili vuri në dukje madhësinë e profesor Ahmetit si mjek dhe kontributin e tij në themelimin e kardiologjisë bashkëkohore shqiptare.

Prof. Dr. Genc Sulçebe, në cilësinë e kreut të "Komisionit të Mjekësisë" pranë Akademisë së Shkencave, mbajti kumtesën me titull "Ahmet Kamberi, figurë poliedrike e mjekësisë shqiptare", i cili solli në vëmendjen e auditorit momente nga karriera brilante

në mjekësi e profesor Kamberit, rolin e tij inovator në kardiologji, punën në klinikën speciale në Tiranë, funksionet publike deri në Ministër i Shëndetësisë, pa lënë mënjanë kontributin e çmuar të Ahmet Kamberit në vendosjen e mjaft protokolleve mjekësore në kardiologjinë shqiptare.

Prof. Asc. Dr. Gafurr Muka, mbajti ligjëratën me temë "Mjeku ynë i veçantë Ahmet Kamberi", duke u fokusuar tek e gjithë veprimtaria shkencore dhe shoqërore e ish-ministrit të shëndetësisë, me një trajtesë shumëplanëshe për Ahmet Kamberin si familjar, si mjek, si funksionar e padyshim edhe si veprimtar shoqëror. Në fjalën e tij Muka kujtoi se karrierën dhe mjaft elementë të veprimtarisë së tij si mjek, Kamberi i ka përmbledhur në librin e tij "Pacienti ynë i veçantë", që është mirëpritur në qarqet mjekësore e më gjërë.

Prof. Dr. Veli Zogu, kardiokirurg i mirënjohur shok fëmijërie me doktor Ahmetin dhe bashkëudhëtarë në profesion përshëndeti pjesmarrësit, kolegët, familjarët me video konferencë që u dëgjua me kërshtëri, për grica jete e episode brilante rreth arritjeve shkencore dhe mjeshtrisë profesionale e përkushtimit në marrëdhënie me pacientët në Bulqizë, në spitalin e Peshkopisë dhe më pas në institucionet më të larta të mjekësisë në Tiranë.

Prof. Dr. Mustafa Khani, në fjalën e tij tha se ai ka bashkëpunuar me Ahmet Kamberin dhe solli në vëmendje të të pranishmëve copëza nga jeta dhe veprimtaria mjekësore e Ahmet Kamberit, sidomos rolin të tij drejtues për të futur kardiologjinë shqiptare (dhe jo vetëm) në hullinë e një profesionalizmi të lartë dhe në krijimin e mjaft protokolleve shëndetësore që vijojnë të jenë edhe sot baza e një funksionaliteti profesional të mjekë-



sisë shqiptare. Në kumtesën e tij me titull "Profesor Ahmet Kamberi mjek i shquar dhe drejtues i talentuar", Khani përmbylli fjalën e tij me vlerësime të veçanta për Ahmet Kamberin si mjek, si mësime dhe si funksionar shtetëror. Prof. Dr. Mimoza Lezha, sot kardiologe e shquar në QSUT, me kumtesën e saj "Një jetë në shërbim të shumë jetëve", tha për të pranishmit se kishte pasur një bashkëpunim të gjatë e të frytshëm me profesor Ahmet Kamberin, duke vënë në pah disa cilësi të rralla të tij si mjek kardi-

olog, si humanist, si njeri i apasionuar pas të rejave shkencore, si personalitet i auditorit dhe natyrisht njeri me kontribute të vyer në mjekësinë shqiptare.

Komisioni I "Shoqatës së kardiologëve" kishte përgatitur një video konferencë me detaje të veçanta të jetës dhe të arritjeve shkencore në mjekësi të doktor Ahmetit, që gjithashtu u ndoq me shumë vëmendje nga të pranishmit në këtë event.

Prof. asoc. Selman Dumani, në kumtesën e tij "Idhulli im profesor Ahmet Kamberi", u shpreh se kontaktet e para me prof. Ahmetin i kujton si ish student i tij dhe foli për një dimension tjetër të Ahmet Kamberit, atë të mësimeve të përkushtuar, njeriut brilant në komunikim, mjekut të dashuruar me të renë dhe këmbëngulës për të adaptuar në mjekësinë tonë arritjet më të fundit shkencore. Ai evidentoj plot arritje të profesorit si studjues i përkushtuar, kërkues i vendosur, realizues i suksesshëm i objektivave në profesion, themelues i revistës shkencore të kardiologjisë, por edhe familjar shembullor, etj që e mbyll fjalën e tij me pyetjen: "Çfarë mund të ketë më tepër një idhull?"

Doktori kardiolog i mirënjohur Themistokli Sinjari, ish mjek në Zërqaq, profesor në kardiologji, mbajti kumtesën me temë "Profesor Ahmet Kamberi figurë fisnike në plejadën e mjekësisë shqiptare", duke sjellë në vëmendje fragmente nga bashkëpunimi me Ahmet Kamberin. Ai evidentoi rolin e Kamberit në

kardiologji, duke e nisur nga spitali i Peshkopisë, ku drejtoi me profesionalizëm të rrallë për dhjetë vjet spitalin dhe e bëri atë pararojë në të gjithë vendin sa i takon trajtimin të pacientëve me sëmundjet e zemrës.

Prof. Dr. Enver Hysa, duke qenë nga e njëjta vendlindje me Ahmet Kamberin, solli për të pranishmit kumtesën me titull "Fëmijëria dhe arsimimi i profesor Ahmet Kamberit". Në këtë kumtesë, e sjellë plot emocion nga gjuhëtari i njohur, u shpalos një përmbledhje e gjendjes familjare, përpjekjeve për shkollim dhe qëndrimin të dinjitetshëm atdhetar të kësaj familjeje, e më tej përmbledhja e gjithë jetës së profesorit të mjekësisë. Nga trajtesa kuptohej një kapërcim vështirësish i djaloshtit nga fëmijëria e deri në majat e mjekësisë shqiptare. Hysaj e quajti Ahmet Kamberin një personalitet frymëzues, figurë që rrezaton mirësi e profesionalizëm dhe me kontribute thelbësore veçanërisht në kardiologjinë shqiptare.

Në emër të familjes, organizatorët dhe të pranishmit i përshëndeti djali i profesor Ahmet Kamberit, Genci, që u shpreh se me këtë "Akademi përkujtimore" ju na lehtësuat dhimbjen e madhe të mungesës së babait dhe ndjehet krenar për historinë brilante profesionale e njerzore të tij si mjek dhe si prind i paharruar për të gjithë.



Të pranishmit që morën fjalën, doktorët prof. dr. Petrit Bara, prof. asc. dr. Nazmi Koçi, u bënë thirrje institucioneve që emri i Ahmet Kamberit të përjetësohej në ndonjë shkollë apo klinikë, apo dhe propozimi që Presidenti i Republikës t'i akordoj titullin e lartë "Nderi i Kombit".

Shpreh mirënjohje të veçantë për pedagogët e mbajtësit e kumtesave dhe kontribuesit që ndihmuan në organizimin e këtij eventi. Eventi u filmua e fotografua nga operatori e reporteri Mahir Jangulli të cilin e falenderojmë. Mirënjohje për të gjithë pjesmarrësit që ndoqën këtë aktivitet përkujtimor. Kujtimi për profesorin Ahmet Kamberi do të jetë i paharruar.

\* Kryetar i Shoqatës Atdhetare Kulturore "Bulqiza",





Periudha e studimeve 1956-1961 i dha mundësinë doktorit të ardhshëm të lexonte, mësonte e praktikonte njohuritë profesionale për t'u bërë mjek.

kumtesa

# MJEKU YNË I VEÇANTË

*Në këtë "Akademi Përkujtimore" kushtuar mjekut të shquar prof.dr.Ahmet Kamberit ndjehem shumë i nderuar, të përzgjedh nga jeta dhe vepra e tij disa veti, disa cilësi dhe disa momente që e portretizojnë dr. Ahmetin si një mjek të veçantë.*



**PROF. DR. GAFUR MUKA**

## • BOTA E TEMLËS DHE BOTA E LIBRIT

Ahmet Kamberi u lind në fshatin Peladhi. Ky fshat është vendosur në prehër të malit të Temlës dhe shtrihet deri në buzë të zallit të Bulqizës. Qysh fëmijë ai e njohu "Botën e Temlës" duke bërë punë fshati. Në një intervistë dhënë TVSH, ndër të tjera, thotë që "qysh fëmijë kam kullotur shqerrat". Po si nisi ta njohë botën e librit Ahmet Kamberi? Shkollën fillore e bëri në fshatin Godvi, pasi Peladhia atëmot nuk kishte shkollë. Djaloshi, që në kohën e lirë kulloste shqerrat dhe e treste vështrimin përpjetë Temlës, tashmë si nxënës e ngulte vështrimin mbi librat dhe e vendoste dorën mbi letrën e bardhë të fletoreve. Ahmet Kamberi nuk ka lënë shënime apo kujtime të cilësuar për vitet e shkollës 7-vjeçare, të cilën e filloi në Zerqan dhe e vazhdoi e përfundoi në Shkodër tek shkolla "Ndoc Mazi", i akomoduar në konviktin "Tom Kola". Në këtë kohë fillon të hedhë hapat e parë në botën e librit. E ndërsa botës se Temlës ia njëhte kufinj të fizikë, bota e leximit zgjerohej e zgjerohej...Po ku ishin kufijtë e saj? Për të marrë një përgjigje për këtë pyetje, ai vazhdoi rrugëtimin nëpër klasa e auditore, nëpër librari e biblioteka, gjithkund në shoqërinë e librit, gjithkund me bindjen se "dija të bën të lirë" dhe të krijon të ardhme.

## • PËRSE STUDJOI PËR MJEKSI

Pas arsimit 7 vjeçar Ahmet Kamberi vazhdoi me frekuentimin e arsimit të mesëm në "Politeknikumin Mjeksor" në Tiranë. Në intervistën e cituar tek RTSH ai nuk tregon ndonjë episod të veçantë nga kjo periudhë veç një bisede me dajën e tij, në përgjigje të pyetjes nëse ishte i vendosur për të studiuar mjeksi edhe duke e ditur që tek ai do të vinin njerëz vetëm duke qarë. Përgjigja: po, dhe unë për këtë po studioj mjeksi që të ndihmoj njerëzit" tregon, që ai tashmë pasionin për librin do ta sendëronte edhe si pasion për literaturën mjeksore. Po çfarë rezultatesh arriti ai në vitet e Politeknikut? Edhe pse nuk kemi dëshmi për këtë, fakti që atij iu dha bursë për studime jashtë vendit, tregon që rezultatet kanë qenë shumë të mira.

## • SHPRESË, ZHGËNJIM, VENDOSMËRI DHE REZULTATE

Vetëm 2 muaj punoi si ndihmësmjek dhe pastaj u nominua që të fillonte studimet në Universitetin Zemellëeiss në Budapest. Por studimet u ndërpre në akoma pa filluar. Shkakun e ndërprerjes së

studimeve në këtë universitet, vetë dr. Ahmeti e shpjegon edhe në librin e tij me tregime "Shif e shkruaj", botuar fill pas vdekjes. Në tregimin me titull "Ditët e vështira të Tetor-Nëntorit 1956 në Budapest" studenti Ahmet Kamberi përshkruan me detaje gjithë çfarë i panë sytë dhe gjithë çfarë i mbeti në mendje nga ajo periudhë e vështirë për popullin hungarez.

Siç del nga ky tregim por edhe nga sjellja e tij pas kthimit në atdhe, Ahmet Kamberi nuk e përjetoi ngjarjen si një shans i humbur për të shijuar jetën jashtë vendit apo si një rast i humbur për studimet e tij. Me gjithë rekomandimin për të pritur një shans të dytë për të vazhduar studimet jashtë, Ahmet Kamberi u regjistrua po atë vit në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë.

## BILANC ARRITJESH NË SPITALIN E PESHKOPISË

Periudha e studimeve 1956-1961 i dha mundësinë doktorit të ardhshëm të lexonte, mësonte e praktikonte njohuritë profesionale për t'u bërë mjek. Në atë periudhë emërimet në profesion bëheshin jo duke vlerësuar rezultatet në

sioni për të lexuar e mësuar në profesionin e tij dhe njohja e gjuhës angleze që ia mundësonte realizimin e këtij pasioni. Ai shkruan: "qysh në vitin 1962 (një vit pas emërimit) isha abonuar në Revistën mjekësore Britanike "British Medical Journal". Dhe ku? Në një qytet periferik si Peshkopia, ku joshja për të frekuentuar kafenetë "me raki e fërnë" ishte vështirë e përballeshme. Por Ahmet Kamberi frekuentonte librarinë e qytetit, ku porosiste literaturë mjekësore. Për doktorin e ri, njëra anë ishte përditësimi i dijeve nëpërmjet leximit sistematik, ana tjetër ishte vënia në shërbim të pacientëve e këtyre dijeve. Për punën në spitalin e Peshkopisë ai shkruan: "Pata gjithashtu mundësi të vë në zbatim metoda të reja mjekimi, të cilat nuk përdorshin tjetërkund atëherë në Shqipëri". Dhe erdhi dita që i gjithë ky aktivitet studimor e aplikues ta çonte natyrshëm mjekun e ri tek specializimi pranë Spitalit Klinik Nr. 1, Tiranë. Në periudhën 2 vjeçare 1967-1969 Ahmet Kamberi u specializua për sëmundjet e brendshme (patologjinë). Pas specializimit ai rikthehet në Spitalin e Peshkopisë, tashmë i certifikuar si specialist. Por mendja e doktor Ahmetit "kulloste" edhe në par-



mësime por sipas parimit "atje ku ka nevojë atdheu". Në zbatim të këtij parimi Ahmet Kamberi, pas përfundimit të studimeve, u emërua në spitalin e Peshkopisë. Në kujtimet e tij ai shkruan: "Menjëherë pas diplomimit si mjek i përgjithshëm u emërova në spitalin e Peshkopisë, në pavionin e sëmundjeve të brendshme". Vini re, ai shkruan "pas diplomimit" dhe jo "pas përfundimit të studimeve"! Pse? Sepse Ahmet Kamberi ka vendosur t'i vazhdojë studimet. Në kujtimet e tij ai shkruan: "Për shkak të punës shumë intensive dhe me larmi të gjerë rastesh (në spitalin e Peshkopisë) u poqa shpejt si mjek. Pata mundësinë që të siguroja librat më të mirë amerikanë të kohës për mjekësinë klinike dhe kardiologjinë". Në këto pak rreshta shquhen dy cilësi të doktor Ahmetit: Pa-

cela të tjera ku ai mendonte se ishte i dobishëm për pacientët e tij. Dhe "parcela" që atij i ofronte "oreks" të mirë, ishte ajo e kardiologjisë. Pa e shmangur detyrimin si patolog, ndihmuar për këtë edhe nga një koleg i tij, Ahmet Kamberi, i hyri punës për të vënë në shërbim të pacientëve me sëmundje të zemrës një elektrokardiograf, tip i vjetër, të cilin e "rinoi" dhe e vuri në përdorim për diagnozimin dhe kurimin e pacientëve.

## MJEK I KLINIKËS SPECIALE

Gjithë arritjet e tij në Spitalin e Peshkopisë nuk mund të iknin pa lënë gjurmë e pa rënë në

(Vijon në faqen 7)





# MJEKU YNË I VEÇANTË

(Vijon nga faqja 6)

sy. Pikërisht pse ndodhi kështu, në vitin 1971, mjeku Ahmet Kamberi emërohet në Klinikën Speciale në Tiranë. Punën në këtë klinikë e fillon si kardiolog. Në vështrimin nga jashtë, ky vend pune atëkohë vlerësohej si i privilegjuar. Mjek i Klikës Speciale? Sa fat paska pasur! Po çfarë mendon dr. Ahmeti? Ai e shihte këtë si një përgjegjësi të madhe, të cilën ishte i bindur që do ta përballonte me atë që ai e quan “guxim klinik”, burimi i të cilit ishte po parimi i tij “Dija të bën të lirë dhe të krijon të ardhme”.

## MJEKU I VEÇANTË TEK PACIENTI I VEÇANTË

6 marsi i vitit 1976 e gjen Ahmet Kamberin si mjek të veçantë pranë një “Pacienti të veçantë”. Shërbimin si mjek i Enver Hoxhës ai e vazhdoi deri në 11 prillin e vitit 1985, duke u angazhuar edhe si kardiolog, edhe si diabetolog, edhe si patolog në plotësim të të gjitha kërkesave për një shërbim të tillë. Gjatë kësaj periudhe ai ishte pjesë e ekipit mjekësor të Enver Hoxhës, krahas emrave shumë të shquar të mjekësisë shqiptare si Llambi Zichishti, Petrit Gaçe, Nikolla Shurbani, Fejzi Hoxha, Hajro Shyti, Isuf Kalo, Ylli Popa, Ali Ajlushani, Sabit Broka dhe Arben Fino.

Në përfundim të këtij angazhimi, mjeku Ahmet Kamberi, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë për t’u rritur profesionalisht, ka fituar tashmë aftësi të tilla, që e lartësojnë atë jo vetëm në nivelin e një mjeku nga më të mirët në vend por edhe të një mjeku me reputacion ndërkombëtar.

## SI KOLEG MIDIS PROFESORËSH EDHE JASHTË VENDIT

Janë me mjaft interes vlerësimet që i janë bërë doktor Ahmet Kamberit, nga mjekë të shquar suedezë e francezë gjatë specializimeve të tij afatshkurtra në shërbimet mjekësore të këtyre vendeve. Në vlersimmet e tyre ai certifikohet si mjeku me “njohuri bazë shumë të mira në fiziologjinë e qa-

rkullimit të gjakut dhe në kardiologjinë klinike” i cili, “brenda një kohe shumë të shkurtër hyri si një anëtar i grupit të mjekëve që trajtonin pacientët kardiakë” (Citim i certifikatës së lëshuar nga Spitali “Sant G-joro”, nënshkruar nga Shefi i Departamentit të Mjekësisë), apo si mjeku që “është çmuar shumë nga gjithsecili (është fjala për personelin mjekësor të shërbimit të diabetologjisë në Spitalin e famshëm Hotel-Djê të Parisit) për kompetencën e tij, mirësjelljen dhe vetëdijen e tij profesionale” (Citim i certifikatës së lëshuar nga prof. Zhorzh Çobrucki, Shef i Shërbimit të Diabetologjisë në Hotel-Djê), apo si mjeku i “integruar plotësisht në jetën e shërbimit (është fjala për Shërbimin e Kardiologjisë të Spitalit Bysiko, Paris) të cilit i ka dhënë një ndihmë të dobishme, të përkushtuar dhe miqësore” (Citim i certifikatës së lëshuar nga prof. Agrezhe Zhan Ge, Shef i Shërbimit të Kardiologjisë në këtë spital).

Vlerësimet e këtyre personaliteteve nuk ishin “fjalë të bukura”, por konkluzione të specialistëve që “fjalën e bukur” nuk kishte “burrë nëne” t’ua nxirrte nga goja pa e merituar.

## STUDJO, GUXO, EKSPERIMENTO DHE SHËRO.

I tërë aktiviteti realizues i Ahmet Kamberit mendoj se bazohet tek parimi i “Guximit Klinik”. Në intervistën për RTSH ai shpjegon çfarë kupton me guxim klinik kur thotë: një guxim që e përjashton aventurën dhe sendërton dijen, e cila fitohet nëpërmjet studimit të vazhdueshëm dhe është e detyrueshme për të ecur përpara. Kontributet e dr. Ahmetit në këtë drejtim janë të shumta dhe shumë të dobishme. Por këtu po mjaftohemi të përmendim 2 prej tyre:

Kontributin në krijimin e “Kabinetit të Provës Ushtrimore” në shërbimin e kardiologjisë pranë Spitalit Klinik Nr.1 në Tiranë, i cili funksionoi mbi bazën e protokollit dhe metodikës së tij si dhe zbatimin e provës ushtrimore edhe te të sëmurët me infarkt akut miokardi të pandërli-

kuar në javën e tretë të sëmundjes.

## AHMET KAMBERI NUK ISHTE AS MODEST, AS MBURRAVEC

Një miku im, ish ambasador, që e ka njohur dr. Ahmetin, pasi lexoi librin “Pacienti ynë i veçantë” më tha: “Është i vërtetë në gjithë çfarë shkruan por... mund të ishte pak më modest”. Çfarë do të thotë të jesh modest kur je i vërtetë-iu përgjigja. E vërteta e përjashton si modestinë ashtu edhe mburraveçërinë.

Dhe Ahmet Kamberi ishte dhe mbetet i vërtetë në gjithë aktivitetet edhe si shkencëtar edhe si kliniçist. Dëshmi për këtë është një volum prej 90 publikimesh si dhe 5 protokolle e metodika shkencore në praktikën klinike e kërkimore të Shërbimit Kardiologjik.

Ai ishte dhe mbetet i vërtetë në angazhimet e shumta të tij ku përmendim angazhimin si pedagog në Fakultetin e Mjekësisë, si themelues i Shoqatës Shqiptare të Kardiologjisë dhe President i saj, si themelues i Revistës Shqiptare të Kardiologjisë dhe Kryeredaktor i saj, si anëtar i Shoqatës Europiane të Kardiologjisë dhe koordinator i saj për Shqipërinë etj.

I vërtetë, i vëmendshëm dhe skrupuloz ka qenë doktor Ahmeti edhe në diagnostimin dhe mjekimin e mijëra e mijëra pacientëve që i drejtoheshin klinikës së tij gjatë kohës që shërbeu në shërbimin privat.

Natyrisht nuk është e mundur ta paraqesësh gjithë kontributin e mjekut të shquar prof. dr. Ahmet Kamberit në një kushtesë, sido që të jetë ajo. Kontributi i tij është ngjizur në kohë me gjithë relievin e përpjekjeve dhe arritjeve, është bërë pjesë e kujtesës së pacientëve të tij me respektin e mirënjohjen për të, është bërë libër i hapur për të gjithë kolegët dhe studentët e mjekësisë, është bërë e do të jetë një referencë e pashmangshme në zhvillimet e shkencës mjekësore jo vetëm shqiptare.

Nderimi për figurën dhe personalitetin e tij nuk është detyrë, ai është më shumë se kaq.



Ish-partizani e kuadri që u ndëshkua për shkak të dënimit padrejtësisht të gjyshit të tij

in memoriam

# RRUGËTIMI I SUKSESSHËM I HAMIT KOÇIT NGA VAJKALI I BULQIZËS

HALIL RAMA – MJSHTËR I MADH

Pesë dekada të veprimtarisë jetësore të Hamit Koçit, si pjesëmarrës aktiv në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, si drejtues në ushtri e në disa sektorë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, janë shembulli më i mire për të kuptuar se jeta është e bukur dhe se askush nuk duhet të dorëzohet, pavarësisht problemeve me të cilat përballet.

Hamit Bajram Koçi nga Lagja Vajkal 1 e qytetit të Bulqizës ishte vetëm 23 vjeç kur u rreshtua në formacionet e Brigadës së 18 Sulmuese Partizane, që u krijua në Sllatinë të Dibrës më 18 gusht 1944 nga batalionet partizane të Dibrës, Çermenikës e Martaneshit, si dhe me vullnetarë të rinj nga krahinat e Dibrës, e që u organizuan në katër batalione. Ai mori pjesë aktivisht në luftimet e kësaj brigade deri në çlirimin e plotë të atdheut nga okupatori nazifashist.

Në këtë vit të jubileut të lavdishëm të 80 vjetorit të çlirimit të atdheut, ai meriton të vlerësohet dhe nderohet, jo vetëm për kontributin e tij si ish-partizan i kësaj brigade, por edhe për kalvarin e mundimshëm të viteve të pas çlirimit, ndonëse kontribuoi në sektorë të rëndësishëm.

## ORIGJINA

Hamit Koçi i përket një prej familjeve atdhetare të Bulqizës, burrat e së cilës, sa herë atdheu u ndodh në rrezik nga pushtimet e huaja turke, serbe, austriake e bullgare do të rreshtoheshin me armë në dorë parkrah luftëtarëve dibranë të lirisë. Paraardhësit e Hamitit, gjyshi Isufi e babai Bajram Koçi, njihen për qëndresën ndaj pushtuesve të huaj.

Këta burra të shquar të Vajkalit, këtij fshati famëmadh e historik në qarkun e Dibrës, - vendi i dy prej betejave gjakatare që Skënderbeu zhvilloi e fitoi kundër ushtrisë osmane të drejtuar nga renegati Ballaban Pashë Badera (1465), shekuj më vonë do të ishin parkrah patriotëve shqiptarë që do të organizonin kryengritjet e mëdha kundër pushtuesve turq.

Ashtu si dhjetra patriotë nga treva e Bulqizës, edhe ata shfaqen ndër beteja si shqipja në palën e flamurit që nuk u asimilua. Përballë joshjeve të armiqve nuk u shitën e nuk u përkulën, por qëndruan heroikisht për të mos e lënë vendlindjen nën pushtimin turk. Isuf Koçi (i vjetër) ishte pjesë e rebelimit të armatosur kundër Perandorisë Osmane në pragun e shpalljes së pavarësisë kombëtare.

Isuf e Bajram Koçi i përkasin pikërisht Vajkalit, fshatit ku i madh e i vogël, burra e gra, u rreshtuan në llogore gjatë luftës 9-vjeçare të Dibrës kundër pushtuesve serbë (1912-1921). Ata do të ishin përkrah patriotit Mehmet Duriçi (1852-1925), udhëheqësit të çetës bulqizake midis viteve 1912-1921.

Ndaj nuk është e rastësishme që kulla e vjetër e Koçajve është djegur dy herë, nga pushtuesit e huaj.

Pikërisht në këtë vatër atdhetarie lindi, kaloi fëmijërinë, u edukua dhe u formua si luftëtar e patriot edhe Hamit Koçi.

## KONTRIBUTI NË LANÇ DHE USHTRINË SHQIPTARE

Hamit Bajram Koçi lindi në 20.06.1920 në fshatin Vajkal, Bulqizë. Pas mbarimit të shkolles fillore dhe shtatëvjeçare ai ka mbaruar shkollën 2 vjeçare ekonomike.

Hamiti, si dhe familja e tij ka dhënë, një kon-

• Ai kujtohet dhe vlerësohet me nderim të veçantë edhe 47 vjet pas ijkjes nga kjo botë, si njeriu me shpirt human që ka lënë gjurmë tek të gjithë. Sepse ka mundur të jetë dhe të mbetet mishërues dhe përçes i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale. Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin KRENARI



HAMIT KOÇI

tribut të rëndësishëm gjatë LANÇ-it. Madje, kur në Vajkal u regjistrua një nga aksionet e para antifashiste në Shqipëri, para se Haxhi Lleshi të kthehej nga konferenca e Pezës në shtator 1942, Hamiti ishte ndër të rinjtë më aktivë në këtë aksion luftarak.

Më pas do të ishte përkrahës i Çetës partizane të Dibrës si dhe bashkëkohës dhe bashkëluftëtar i dëshmorëve Latif Përkola e Asllan Keta.

Që me krijimin e saj më 18 gusht 1944 ai u rreshtua në Brigadën e 18-të Sulmuese si partizan, ku ka marrë pjesë në të gjitha luftimet e kësaj brigade deri në çlirimin e vendit.

Qysh me aksionet e para të kësaj brigade ai u shqua për forcën e organizimit, të disiplinës e të veprimeve, duke dhënë shembullin e një djaloshi luftarak kundër pushtuesit. Bashkëkohësit e mbanjnë mend për dinamizmin, guximin dhe shpirtin e sakrificës dhe të disiplinës.

Këto virtyte do ta karakterizonin Hamit Koçin edhe pas vitit 1944 kur u transferua në Gjirrokastër si shef prapavije në Divizionin Ushtarak. Por ndonëse shquhej si kuadër me vizion bashkëkohor dhe i përkushtuar ndaj detyrës edhe ai nuk do t'i shpëtonte luftës së klasave.

## KUADRI SHEMBULLOR QË E NDOQI NGA PAS "HIJA E BIOGRAFISË SË FAMILJES"

Në harkun kohor të viteve të para të pasçlirimit kur kryente me devotshmëri detyrën e shefit të prapavijës të Divizionit të Gjirrokastër, Hamit Koçi, do të ndëshkohej padrejtësisht, për faktin se gjyshi i tij, Bajram Koçi do të dënohej me 15 vjet burgim me akuzën absurde për "veprimtari kundër pushtetit popullor", pasi kishte strehuar tre miq të tij të ardhur nga Gostivari i Maqedonisë, të cilët ishin në ndjekje nga sigurimi shtetit të asaj kohe. Pasi beri tre vjet burg mori pafajësinë, por ndërkohë, ni-

sur nga kjo ngjarje, Hamiti transferohet, ku për një periudhë të shkurtër ka punuar si zëvendës drejtor në Maternitetin e Tiranës. Tashmë, i martuar me Jeme Hasan Gjimi nga Fushë Bulqiza do të gëzoheshin nga lindja e djalit të parë, Isufit që ndër vite e dekada do të bëhej një nga kuadrot drejtues më të aftë që ka njohur Bulqiza. (Ai, nuk harrohet kurrë, si drejtori që drejtoi me zotësi dhe solli veç të mira për njerëzit, si drejtues i bujqësisë dhe themelues i fermës në Fushë Bulqizë)

Ndërsa Isufi rritej, ata jetonin në ish - pallatin e Qazim Mulletit, e ndërkohë familja e tij trashëgonte si pronë edhe një dyqan ushqimor tek Pazari i Ri. Këtu spikat edhe dimensionin e tij në rrafshin njerëzor, sepse kishte ndjeshmëri shumë të theksuar për miqtë e shokët, sidomos për ata nga vendlindja e tij. Ndaj nuk ishte rastësi që të priste e përcillte me bujari vajkalarët e të tjerë nga fshatrat për rreth Vajkalit që vinin në Tiranë për hallet e tyre. Hamit Koçi përpiquej t'u gjendej pranë në çdo formë, për t'u zgjidhur problemet e tyre.

Kush trokiti asokohe në derën e Hamit Koçit dhe nuk gjeti zgjidhje për hallet e veta?!

Por megjithë kontributin gjatë LANÇ e në këto funksione të rëndësishme si kuadër shembullor, ai do të provonte kalvarin e mundimshëm për shkak të "hijes së biografisë së familjes", duke e degdisur si punëtor në ish-NB Peshkopi, sektori Bulqizë dhe NFP Bulqizë.

Në vitin 1946 transferohet drejtues në minierën e kromit Bulqizë, në sektorin e furnizimit të punëtorëve. Vështirësitë ishin të shumta, dhe pikërisht në ato kushte të pamundësisë së sigurimit të gjërëve më të nevojshme e më jetike, familja e tij do të shtohet edhe me dy fëmijë: Këtu lindën Uke dhe Rihana Koçi.

Megjithë përvojën dhe aftësitë profesionale, Hamit Koçi do të provonte disa herë ulje-ngritje në karrierën e tij.

Kështu, në vitin 1948 transferohet në Rubik si drejtor i NFP ku ka jetuar 8 vjet sëbashku me familjen e tij, tashmë edhe me dy fëmijë të tjerë, Kadriun dhe Dallëndyshen.

## SI SHPËTOI NGA "DEFIÇITI" I 2 KG SHEQER?!

Është vërtetë sa qesharak aq edhe tronditës rrëfimi i veteranit Isan Bundo, luftëtarit, patriotit e kuadrit që e pësoi me burgje e internime, pas përplasjes me të mëdhenjtë e ish nomenklaturës komuniste në të famshmen Konferenca e Tiranës e vitit 1956.

Me urdhër të Kadri Hazbiut, atë e dërguan në Rubik të verifikonte akuzën e ngritur nga operative i sigurimit të zonës ndaj Hamit Koçit, nëse vërtetë ai kishte vjedhur dy kg sheqer nga magazinat e NFP-së, ndërmarrje të cilën ai e drejtonte, dhe ku një nga magazineret kishte dalë deficiet, pikërisht me dy kg sheqer.

"Troktika në derën e zyrës së Hamitit dhe ai më ftoi të hyja brenda. Pasi i thashë qëllimin e kësaj vizite, Hamiti më thotë: Nëse ta bëj kafënë me sheqer, vërtetë i kam vjedhur ato dy kg! Nëse jo, duhet gjetur hajduti i vërtetë...Pas pak troket sërish dera dhe shfaqet operativi i sigurimit të

(Vijon në faqen 8)



# in memoriam

Sërish Hamit Koçi nuk inkurajohet por rikthehet në vendlindje për t'iu përkushtuar familjes së tij. Nis kështu sërish rrugëtimin e jetës së tij me ecejake.



**DJATHTAS: ISUF, RIHANA, DALLENDYSHE, BUKUROSH DHE FIQE KOÇI BEGU; MAJ-TAS: JEME KOÇI GJIMI, ALIE KOÇI TUMA DHE UKE KOÇI**

# RRUGËTIMI I SUKSESSHËM I HAMIT KOÇIT NGA VAJKALI I BULQIZËS

(Vijon nga faqja 8)

zonës që kërkon të më takojë mua. Pasi i thashë të presë jashtë, Hamiti më thotë: Ja kush është hajduti i sheqerit! Kemi bërë inventarin e magazinës dhe magazinierja që doli deficiet na ka deklaruar se sheqerin e ka marrë operative i sigurimit.

Pasi e takova operativin i thashë se kam ardhë me urdhër nga lart të arrestoj atë që ka vjedhur sheqerin. Pas dy ditësh vjen një grup nga Ministria e Tregtisë që provoi atë që më kishte thënë Hamit Koçi, se sheqerin e kishte marrë operativi. Zbulimi i kësaj të vërtetë më solli përplasje me Ministrin dhe përfundova në burgje e internime, por amë Hamit Koçi mbeti miku im”, rrëfen Isan Bundo”, .

## PËRJASHTIMI NGA PARTIA PAS PËR-BALLJESME ISH SEKRETARIN E PARË MUÇO PAJENGA

Në vitin 1960, Hamit Koçi transferohet familjarisht në Ulëz, si drejtor i NFP-së. I përkushtuar ndaj detyrës dhe familjës së tij, tashmë me 5 fëmijë sepsë këtu lind edhe Bukuroshi (sot ndër sipërmarrësit më të suksesshëm në rang vendi), kur sapo kishte mbushur dy vjet në këtë detyrë me përgjesi, për të rikthehen sërish hijenat e luftës së klasave. Në vitin 1962, ndaj tij sajohen akuza absurde që do të vijonin deri në përplasje me ish Sekretarin e Parë të Komitetit të PPSH të rrethit të Matit, Muço Pajenga dhe në një plenum partie të atij viti e përjashtojnë nga partia.

Vërtetë situatë kritike për kuadrin vizionar që po ndëshkohej me akuzën se babai i tij ishte dënu-

ar për veprimtari kundra pushtetit popullor. Dhe jo vetëm kaq, por falanagat e atij pushteti kishin hulumtuar edhe më thëllë, duke “zbuluar” edhe kleçka tjera në biografi, pse dajat e tij ishin shpallur “kulak”, ngaqë s’pranonin të dorëzonin tokë e bagëti në ish-kooperativën bujqësore .

Sërish Hamit Koçi nuk inkurajohet por rikthehet në vendlindje për t'iu përkushtuar familjes së tij. Nis kështu sërish rrugëtimin e jetës së tij me ecejake. Pesëmbëdhjetë vitet e fundit të jetës së tij, (nga viti 1962 deri në 7.07.1977 kur ndërroj jetë nga një sëmundje e rëndë, hemoragji cerebrale), punoi në NFP me ndërshmëri, i rrethuar nga miq e shokë të shumtë që e donin dhe e respektonin.

## MESAZHET QË PËRCJELLIN SHEMBULLIN E TIJ KANË EMRIN KRENARI

Në rrugëtimin e këtij idealisti elitari, që nisi nga radhët e forcave partizane; vijoi si Shef Prapavije në Divizionin Usharak të Gjirokatrës, si zëvendës Drejtor i Maternitetit të Tiranës, Përgjegjës sektori e Drejtor i NFP në Bulqizë, Rubik e Ulëz, gjejmë episode dhe fakte që e rendisin personalitetin e tij me atë të personaliteteve të shquara shqiptare, të cilët gjithë jetën ia kushtuan atdheut të tyre. Ai bën pjesë në plejadën e luftëtarëve të lirisë e drejtuesve të Ushtrisë shqiptare që kontribuan për rindërtimin dhe konsolidimin e disa sektorëve të rëndësishëm dhe ia doli të jetë kurdoherë i suksesshëm. Me performancën e tij të shkëlqyer, falë përkushtimit ndaj profesionit, ai do të dallohej kudo e kurdoherë, si kuadër kompetent e me përvojë. Vlera e veprës së tij qëndron jo vetëm në kryerjen më së

miri të detyrave të tij funksionale, por edhe në atë të punës praktike për t'i shërbyer sa më mirë nevojave të popullit. Kësisoj ai bëri realitet ëndrrën për t'u shërbyer hallexhinjve nga Bulqiza, Mati e Mirdita, jo vetëm me kompetencën profesionale, por edhe me papërtueshmërinë e fjalën e ëmbël. Ai ishte kuadri shembullor që manifestonte cilësi të shquara profesionale, humane dhe sociale dhe si i tillë edhe me një rreth të gjerë miqsh dhe një popullaritet mahnitës. Marrëdhëniet me njerëzit i konsideronte të shenjta. Ai i donte dhe i çmonte shumë shokët e tij, qofshin ata kolegë, shokë të rinisë, fshatarë, qytetarë, të rinj apo pleq. Përveç dashurisë për njerëzit dhe mikpritjes, kishte edhe një pikë tjetër të fortë, që ishte bashkëshortja e tij fisnike, Jeme Hasan Gjimi. Ai e vlerësonte dhe e konsideronte këtë si fat të madh. Sepse jo çdo-kush do të kishte qenë e gatshme që të priste pa pushim dhe në çdo orë atë fluks miqsh e vizitorësh në shtëpi. Banesa e tij (ish shtëpia e Qazim Mulletit) në Tiranë, në ato vte që kthyer në një shtëpi të dytë për bulqizakët e dibranët e shumtë, sa herë që u duhej të vinin për një vizitë në spital apo për të parë fëmijët e tyre ushtarë e nxënës. Megjithë ngarkesën në punë, Hamit Koçi kishte mirësinë dhe gatishmërinë që të angazhohej pa kursim në zgjidhjen e çdo halli të njerëzve në nevojë. Madje edhe kur ishin probleme që nuk i kishte në dorë vetë, ai shfrytëzonte të gjitha mundësitë dhe lidhjet miqësore për t'ua zgjidhur njerëzve ato. Ndaj, me të drejtë, ish partizanin e kuadrin shembullor nga vendlindja e tyre, kur shërbente në kryeqytet, bulqizakët e kanë konsideruar si “Ambasador i Bulqizës në Tiranë”. Madje çdo ambasador do t'a kishte zili përfaqësimin dinjitoz të humanizmit dhe vlerave të familjes dhe vendlindjes nga ai vinte, si dhe humanizmin e pashtershëm e virtytet e pashoqe që ai shfaqte në të mirë të njerëzve. Në profilin e Hamit Koçit ishin bërë bashkë krenaria individuale, krenaria e fisit, krenaria e vendlindjes, e krahinës dhe krenaria kombëtare e bazuar tek historia, luftërat legjendare, puna dhe arritjet e të parëve të tij, punëtorë dhe bujarë, por dhe të shokëve të luftës e të Ushtrisë, si lajtmotivi i jetës dhe veprës së tij. Ai u nda nga jeta më 7.07.1977, duke mbetur në kujtesën e bashkëqytetarëve nga Bulqiza, miqve e shokëve të tij të shumtë, si simbol i njeriut të virtytshëm, duke lënë pas fëmijët e tij shembullorë (Isufin, Uken, Rihanen, Kadriun, Dallëndyshen e Bukuroshin) që të gjithë njerëz emërmirë për familjen e shoqërinë.

Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin KRENARI.



**BASHKËSHORTJA E HAMITIT, JEME KOÇI-GJIMI**



Në Bulqizë, pas lufte, mbasi kishin rënë deshmore  
Asllan Keta dhe Latif Përkola, nga të gjallët, më i  
vlerësuar mbeti Hamit Koçi

kujtime

# Pse Hamit Koçi, për bulqizakët dhe jo vetëm, ishte dhe mbetet i pavdekshëm?

Hamit Koçit, në çdo odë burrash, në Bulqizë dhe jo vetëm, i lirohej qoshja. Zgjidheshin yzmetçijtë tek ajo dhomë ku ulej Ai



NGA AZIS KETA

Unjoha me jetëshkrimin e Hamit Koçit shkruar me aq kulturë e kompetencë nga Halil Rama dhe, më pëlqeu. U ndjeva i vlerësuar që, Halili, më kërkonte mendim, para se të botohej. Dhe ja mendimi im: Tek ky jetëshkrim (që për mua është studim) i të pavdekshmit Hamit Bajram Koçi, ndesha befasi që, unë, nuk i dija. Ndaj dhe, u mrekullova, sidomos, me pasluftën.

Po pse për bulqizakët dhe jo vetëm, Hamit Koçi ishte dhe mbetet i pavdekshëm? Sepse, sipas të vjetërve, as Bajram Koçin i Vjetër që luftoj në Betejën e Drinit (1840), as Isufi i Vjetër (që luftoj në krah të Sheh Fejzës në Xixull), as Bajram Koçi i ri, që bëri 9 vjet luftë me krajla (1912- 1921), as Hamit Koçi, që e filloi luftën në shtator 1942 (nën komandën e Dali Ndreut), nuk ishin "luftëtarë katundi", por të "Mbrojtjes Komëtare", ku pjesë ishte edhe çeta e Vajkalit, dy lagje të së cilës i komandonte Bajram Koçi.

Asllan Keta, Latif Përkola e Hamit Koçi, në Br 18 S, në përbërje të së cilës luftuan, nuk ishin luftëtarë katundesh por të UNÇI. Ndaj, nëse ndjekim kalendarin histoik të ngjarjeve, gjejmë:

## BULQIZAKËT E "KOHËS SË HAMIT KOÇIT"

Kur u krye aksioni Luftarak tek "Gurët e Skënderbeut" kundër postës italiane" (adresuar për tek Nën Prefektura e Zerqanit), ishte shtatori i vitit 1942 që, shënonte një nga aksionet e para kundër fashizmit dhe këtu, edhe bulqizakët e "Kohës së Hamit Koçit" me çetën e tyre.

Kur mori pjesë në aksionin e "Gurëve të Skënderbeut" dhe "rimarrjen e minierës" nga konçensionari Italian, Hamit KOÇI ishte 22 vjeç.

Kur, me Dekret, u anulua koncesioni (1945) dhe miniera kaloi në vartësi të shtetit shqiptar (me akt themelimi dhe status juridik, ku cilësohej dhe kapitali themelor) Hamit Koçi ishte 25 vjeç dhe, i sapo dalë nga lufta me bashkëluftëtar dhe komandant Dali Ndreun, qysh në vitin 1942.

Ky kalendar ngjarjesh, përkon dhe me një dëshmi të rrallë të Ramadan Ketës, bashkëkohës me Hamit Koçin,



DJATHAS BAJRAM, ISUF DHE HAMIT KOÇI - MAJTAS SHAHIN, FIQE, HAJRIE DHE UKE KOÇI

por një vit më i vogël se ai.

Pse e quaj dëshmi të rrallë? -Sepse më përkon me burimet historike dhe arkivore dhe, kjo përputhmëri, i jep dëshmisë cilësinë e provës së tretë.

Pse u persekutua Hamit Koçi pasi kishte mbaruar lufta

dhe Ai, jo vetëm doli gjallë, por edhe fitimtar?

Dëshmitarë okularë e protagonistë në ngjarje arsytetore se: "Në Bulqizë, pas lufte, mbasi kishin rënë deshmore Asllan Keta dhe Latif Përkola, nga të gjallët, më i vlerësuar mbeti Hamit Koçi. Veç Hamitit, koçallarët, si fis, njiheshin historikisht për traditë luftarake në shekuj dhe kjo njëhej edhe nga personalitetet e larta të pasluftës si: Haxhi Lleshi dhe Dali Ndreu. Por, kur karrikja e Ministrisë të Brendshme do kalonte nga Haxhi Lleshi tek Koçi Xoxe dhe, dhërbimet sekrete serbe kotrollonin gjithë institucionet, vjen iformacioni se, Bajram Koçi, bën veprimtari kundër pushtetit popullor, e për këtë do të dëmohej me 15 vjet burg.(Bëri vetëm tre dhe u lirua me pafajësi). Sipas Bajram Koçit, 9 vjet luftë me serbët na shkoj kot, sepse, Tito, atë që nuk na e mori me pushkë, na e mori me tradhëti. Kush tradhëtojt? Kjo, ishte në thelb, akuza.

Kur Bedri Spahiu, i deleguri i Byrosë Politike për pravijat e ushtrisë, i kërkoi se cilin do propozonte për në divizionin e Gjirokastrës, për prapavijën, Dali Ndreu, mes dhjetra kuadrove të vartësisë direkte, do ndalonte gishtin tek një emër i përveçëm: Hamit Koçi! Arsytimi i propozimit ishte: "E njoh në betejat luftarake që në shtator 1942. Nga viti 1943, partizan në Br. 18S. Ka "laps të hollë". Nuk e njeh tradhëtinë. Unë, nuk kam kandidaturë më të be-

suar se ai". I bindur në këtë ërasyetim Bedri Spahiu firmos emërimin e Hamit Koçit. Nga ky moment, nga dibranët, në shërbimin logjistik të ushtrisë shqiptare, mbas Dali Ndreut, renditej Hamit Koçi nga fshati Vajkal (i Bulqizës). Por shpallja e Bedri Spahiut dhe Dali Ndreut "armiq të Pushtetit Popullor", të cilët kishin vlerësime pozitive për Hamit Koçin, renduan mbi të, në vitet që pasuan. Gjithsesi, përsëri, ju besuan gjithnjë detyra të rëndësishme ekonomike, aty ku ishte interesi më i lartë. Ndër to dhe Hidrocentrali i Shkopetit, ku gjithë mbështetja logjistike ishte e përqëndruar në qytetin e Ulzës.

## SI E KUJTOJ UNË HAMIT KOÇIN?

Kur vëllai im, në atë kohë kthehej nga një seminar për kontabilitetin nga Tirana (Ministria e Industri Minierave), në kthim për në Bulqizë, im vëlla, shkon për mik, në Ulzë, tek Hamit Koçi. Në kthim, Hamiti, mbasi kishte dëgjuar nga im vëlla se kisha dëshirë për shkollë, pa më njohur fare, më sjell dhuratë një çantë librash, disa fletore dhe një kuti lapsash me ngjyra, me shënimin: "Për ty, Hamiti!" Ky ishte kujtimi i parë i imi për Hamit Koçin, kur ai ishte Drejtor në Ulzë dhe na solli çantat bashkë me paisjet. Pastaj e kujtoj me Mexhit Shehun, Kamber Duriçin, Ramadan Ketën dhe elektrikist Mexhit Balën. Hamiti, bashkë me Ece Xhimistikun, diskutonin se nga do vinte linja e dritës elektrike për Vajkalin, nga motorrat (Gjeologjia) deri tek Duriçet, Allmetet, Mashnora dhe Koçallarët (si fillim). Pastaj lagjet e tjera (Sallake dhe Alije). Aty kam fiksuar, me kuriozitetin dhe përqëndrimin e një fëmije, llojin e makinës që kishte Hamit Koçi. Kur dola

oficer në vitin 1967, në FUD, pashë të parkuar po atë llojë veture që kisha parë tek Hamit Koçi. Më thane se kjo ishte makinë e të ndjerit Myslim Keta dhe ishte prodhim amerikan.

Ja dhe një fajt tjetër: - Ku dinim neve çështje regjistrim kadastral i trojeve në "Djerr Kercuni", sot lagja "Gjeologu"- më thoshte Ramadan Keta, po mos na orizontonte Hamit Koçi? Ai, udhëzoi Mexhit Shehun, Kamber Duriçin se nga duhej filluar. Se, për çështje ekonomike, - sipas Latif Shehut, Hamit Koçi, kishte shok vetëm veten. Njihte ligjet në majë të gishtave. Ishte Kamberr Duriçi që ndoqi problemin sipas orientimit ligjor që rekomandoi Hamitit dhe u regjistruan troja në qytetin e vjetër, qysh në vitin 1952, ende pa u miratuar vija e verdhë e Qyrtetit në vitin 1960, një rast i rrallë në shkallë vëndi.

Hamit Koçit, në çdo odë burrash, në Bulqizë dhe jo vetëm, i lirohej qoshja. Zgjidheshin yzmetçijtë tek ajo dhomë ku ulej Ai.

Shkolloj fëmijët, me gjithë kufizimet e kohës. Dhe nëse Hamit Koçi, shkroi pavdekshinë e vet, "fruti" ishin ata katër djem, secili më i mire se tjetri: Isufi, Uke Kadriu dhe Bukuroshi. Sot, i biri Hamit Koçit, Bukuroshi është lider në Ballkan në industrinë minerare të fabrikave të pasurimit (të kromeve të varfëra), me tre të tilla: Bulqizë, Has dhe Kosovë. Ai, zotëron me leje minerare, disa vendburime si në Cërruë, Ternovë dhe jo vetëm. Kur pyesin se cilës periudhe i pëkasin këto investime, populli përgjigjet thjeshtë: Këto janë "të kohës së Bukurosh Koçit". Pleqtë, parapëlqenjë t'i quajnë: Këto janë të djalit të vogël të Hamitit.



# Festë në fshatin e martirizuar

Viktimë e vendimit famëkeq të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të 1913-ës, që edhe fshati Viçisht i Dibrës, gjysma e njerëzve të gjakut e fiseve të të cilit mbetën në Dibrën e Madhe, si edhe të disa zonave tjera kufitare që ju aneksuan ish-Jugosllavisë. Për afro një shekull, u ndanë për së gjalli njerëz e familje të një gjaku e fisi.

Dhe si të mos mjaftonte kjo tragjedi njerëzore, sërish sistemi i diktaturës do të ndiqte politika përçarëse edhe për banorët e këtij fshati me histori të lavdishme.

Një ndër rastet e shumta të këtij kalvari është edhe Hasan Cami, ish bashkëlufëtari i Heroit të dy luftime Botërore Ahmet Cami, që me krijimin prej tij të çetës antifashiste të Gollobordës. Edhe Hasani ishte ndër 19 burrat e këtij fisi që për vepërimtari patriotike u burgosën nga fashistët italianë në burgun famëkeq të Tiranës në prill 1941 (mes të cilëve katër pushkatoheën dhe tetë të tjerë bien dëshmorë), por çuditërisht, ky pinjoll i këtij fisi emërndritur, pas çlirimit arrestohet dhe dënohet me akuzën absurde të sajuar nga ish sigurimi famëkeq i shtetit diktatorial "agjitacion e propagandë", dënim ky që do t'ju kushtonte rëndë edhe pjestarëve të familjes së tij që u persekutuan për vite e dekada të kohës së monizmit.

## EMIGRANTI NGA VICISHTI, SI FAKTOR PËRBASHKIMI

Tetëdhjetë vjet pas atij akti barbar, Klodian Cami, (stërnipi i patriotit Hasana Cami), President i Shoqatës "Shqiponja" (të emigrantëve shqiptarë) në Reggio Emilia të Italisë, identifikohet si faktor përbashkimi, jo vetëm i Camëve, por i gjashtë fiseve: Cami, Lika, Xheka, Tola, Suma, Markja e Izvira, duke inicuar dhe organizuar një festë madhështore mbrëmjen e 17 gushtit në oborrin e shkollës "Fasli Cami" në Viçishtin e Epërm, një fshat ky me bukuri të rralla natyrore, në prehërin e maleve. Dhe jo vetëm kaq, por siç do të shprehej me fjalën e tij artistike moderatori i këtij eventi, Mjeshtri i Madh Defrim Methasani: "Të gjithë ndjehet kënaqësi dhe krenari njëherësh që janë pjesë e kësaj feste madhështore në fshatin që ka më shumë heronj e dëshmorë se sa shtëpi, në fshatin që ka nxjerrë dhjetra personalitete me rrezatim mbarëkombëtar, si ministra, deputetë drejtues institucionesh kryesore qëndrore, apo dhe kampionë Europe e bote në sporte të ndryshme, si vëlla e motër Tefta e Mojs Cami, shkrimtarët e njohur Sakip, Shpëtim e Agron Cami, drejtoresha e QSU Tiranë, Prof. dr. Alma Cami, kampioni i botës në boks Adriatik Cami etj.

Po. Wshtë vërtetë kënaqësi për mjeshtrin e moderimit dhe ikonën e gazetarisë sportive e të dokumentarit televiziv Methasani, të jetë pjesë e kësaj feste dhe ta moderojë atë, një traditë që po zgjerohet nga viti në vit me kthimin e mërgimtarëve në vendlindje, investimin dhe kujdesin e tyre për aktivitetet të bukura si ky i sotmi. Këtë kënaqësi dhe krenari do ta shprehë edhe kryetarja e bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri. Në fjalën e saj përshëndetëse ajo e konsideron Viçishtin një fshat me traditë të hershme kombëtare, me dëshmorë dhe heronj të shumtë, për shkak të natyrës dhe ndjenjës së fortë kombëtare, por edhe me të përndjekur politikë dhe me personalitete në fushën e arsimit dhe shkencës, dhe kjo histori ja shton përgjegjësinë për të bërë më shumë për infrastrukturën e mjedisin e këtij fshati.

Qytetarja e parë e Bashkisë Bulqize, znj. Festime Mjeshtri tha se e mirëpriti menjëherë ftesën për t'ju bashkuar dhe për të kontribuar për ta rregulluar shkollën që mban emrin e dëshmorit "Fasli Cami", për këtë ditë festive. Ajo është edhe ish - nxënëse e kësaj shkolle, kështu që përgjegjësia e saj që e shumëfishet, siç pohuan edhe organizatorët tjerë të kësaj feste. Duke përgëzuar Klodian Camin për jetëzimin e mallit dhe dashurisë për familjen dhe mbi të gjitha për institucionalizimin e kësaj feste, ajo ftoi banorët e 63 fshatrave të bashkisë Bulqizë të marrin shembullin e Viçishtit dhe ta shikojnë bashkinë si partnere.

I pranishëm në këtë festë edhe depuetei demokrat Xhelal Mziu, ndërsa prshëndeti qindra pjesëmarrësit e në veçanti bijtë emigrantë të këtij fshati, mirënjohje të veçantë shprehu për Klodian Camin. Ai tha se ishte i entuziazmuar që ndodhej mes banorëve të fshatit historik të Viçishtit, në juridiksonin e njësisë administrative Gjoricë. Mziu vlerësoi egon e jashtëzakonshme të Klodian Camit për të maksimalizuar dhe transmetuar tek bashkë-



moshtarët e tij çdo vlerë të Shoqatës "Shqiponja" në Reggio Emilia që ai ka themeluar dhe drejton prej dy dekadash (Ai është edhe sponsor i ekipit të futbollit "Shqiponja" që këtë vit arriti në kategorinë C1.).

## NË TETOR 80 VJETORI I SHKOLLËS "FASLI CAMI"

Fjalë zemre për këtë djalë të Viçishtit thanë në përshëndetjet e tyre edhe znj. Lirie Teodori, Drejtore e Shkollës "Fasli Cami" dhe Prof. dr. Shpëtim Cami, kryetar i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, djalë i këtij fshati dhe ish - nxënës i kësaj shkolle. Prof. Cami vlerësoi angazhimin e kryebashkiakes Festime Mjeshtri në mbështetje të Festës së Diasporës së fshatit Viçisht, si dhe përgatitjet për 80 vjetorin e Shkollës "Fasli Cami", me synim krijimin e një muzeu të shkollës në muajin tetor të këtij viti që përkon edhe me 80-vjetorin e çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist..

Fasli Cami, emrin e të cilit mban kjo shkollë lindi në nëntor të vitit 1912 në fshatin Viçisht të Dibrës. Shkollën fillore 6 vjeçare e kreu në Internatin e Kastriotit të Dibrës nga viti 1920 deri në vitin 1926. Më 1927 u pranua në Shkollën Mbretërore. Në vitin 1931 u transferua në gjimnazin e shtetit në Tiranë dhe vazhdoi studimet në këtë gjimnaz deri në fundin e vitit 1932, kohë kur e përjashtuan se kërkoi të drejtën si dhe shfaqti shenja rebelizmi ndaj padrejtësive. Në këtë kohë Fasliu ishte në një shkollë me Mehmet Shehun, i cili më vonë në kujtimet e tij do të shkruante se s'kishte takuar në jetën e tij djalë më trim se një dibran me emrin Fasli Cami. Me shumë përpjekje u ripranua për të vazhduar studimet në shkollën normale të Elbasanit. Në janar u emërua mësues, në vitin 1939 u transferua në Gjoricë, ku shërbeu me nder, përgjegjësi dhe ndërgjegje deri më 6 prill 1943, deri në momentin kur fashistët italianë e vranë në kodrat e Gjoricës. Mësues e nxënës të Shkollës së Viçishtit, në këtë 80 vjetor të krijimit të saj ndjehen më krenar se kurrë që ajo mban emrin e mësuesit dëshmor Fasli Cami.

Prof. dr. Shpëtim Cami, në fjalën e tij vlerësoi gjithashtu dakortësimin me kryebashkiaken Mjeshtri për ide që duhen mbështetur në çdo fshat, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë.

Pjesëmarrësit i përshëndeti gjithashtu kryetari i degës së LID për Maqellarën, gazetari e shkrimtari Osman Gjili, kampioni i botës për dy kategori në boks Adriatik Cami etj. Mësuesi veteran Avni Mera, ish - drejtor për 8 vjet i kësaj shkolle shprehu kënaqësi të veçantë që ndodeh mes ish dhjetra nxënësve të tij, sot në profesione e funksione të ndryshme në Bulqizë, Peshkopi, Tiranë e diasporë.

Kënaqësi të veçantë që ndodheshin mes djemve e vajzave viçishtash shprehën edhe nënkryetari i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, z. Musa Riçku, kryetari i degës së PD, avokat Shaqir Manjani, njëherësh anëtar i këshillit të Bashkisë Bulqizë dhe nënkryetari i këshillit të kësaj bashkie Z. Munir Sinani. Në fjalët e tyre, emërues i përbashkët është mirënjohja për Klodian Camin, iniciator dhe organizator i kësaj feste mbresëlënëse. Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin "krenari". Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet...E pikërisht në këtë shtrat ka ecur dhe ecën Klodian Cami, i përshtatur mirë me kohën, bujar, fisnik, humanist i pashoq, intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që ka çarë në jetë me mençuri e sakrificë.

## FESTA E VIÇISHTIT, ME RREZATIM NBARË-KOMBËTAR

Festa e Viçishtit rizgjoi nostalgjinë e bnorëve të tij, veçmas atyre që jetojnë e punojnë jashtë Shqipërisë. Klodian Cami është njëri prej atyre djemve që kthen kokën pas, duke krijuar mundësinë e gëzimit e bashkimit të njerëzve përmes organizimit të kësaj feste të paparë në fshatin e tij.

Impresione ngjalli kjo festë edhe tek miqtë e tij të ardhur nga SHBA, Italia, Gjermania, Greqia, Gostivari e Dibra e Madhe.

"Uroj që kjo festë të përhapet në gjithë Shqipërinë", thotë Gentian Shero nga Kavaja, kryetar i Shoqatës "Nënë Tereza", në Trento të Italisë, sponsor dhe president i shkollës "Artur Lleshi" dhe ekipit të futbollit "Iliria" të emigrantëve shqiptarë në këtë rajon të Italisë. Urimet të tij i bashkohet edhe Bujar Tabaku, nga Kavaja që jeton në Parma. Ai thotë se me shembullin e tij, me shqiptarizmin e spikatur në drejtimin e shoqatës "Shqiponja", Kloian Cami është bërë shembull frymëzimi edhe për Forumi e Guas Shqiptare, me presidente znj. Marsida Mediu që është bërë zëri i diasporës në Itali. Gentiani dhe Bujari na flasin me përzemëri edhe për ndihmësen që Klodiani ka dhënë për shkollën shqiptare "Skënderbeu" me drejtor Durim Lika nga Manza dhe mëues Zamira Shkurti nga Lushnja, Sabri Kulla nga Durrës, shkollë kjo ku mësojnë 65 nxënës, fëmijë emigrantësh shqiptarë. Mirënjohje dhe respekt të veçantë për Klodian shprehën edhe Ibrahim Kolari në emër të diasporës shqiptare në Nju Jork, Miçe Duka, Kryetar i Shoqatës Kulturorë Artistike "Dibra e Madhe", Ismaili nga Gostivari, anëtar i shoqatës "Shqiponja", Resul Uzini nga Gostivari, si dhe bashkëshortët Sugare dhe Gjovalin Suzaj nga Tropoja, Urimet të tyre të përzemërt për Klodian Camin, djalin e shqiptarisë në Itali i bashkohet edhe kunata e tij, Alma Skuka që ka ardhur nga Franca për të bërë disa foto nga ky fshat perlë e natyrës, si dhe Drita Ahmet Cami (Garuli) që kishte ardhur nga Gjermania.

"Sa i bukur duket viçishtit këtë mbrëmje të 17 gushtit. Ky vend është i shenjtë për ne. Është kënaqësi e veçantë që bëhemi bashkë, në këtë bashkim vlerash...Sonte jemi shumë më shumë nga sa e mendonim, por duhet të ishim shumë më shumë... Këtu tek kjo shkollë me histori 80 vjeçare nisi sot ky takim që do jetë i përvitshëm", thotë ndër të tjera i emocionuar protagonist kryesor i kësaj feste, Klodian Cami. Dhe në morinë e miqve të shumtë, përveçon mjekun Bajram Xheka dhe mësuesin veteran Fehmi Lika, ish kryetar i fshatit Viçisht, që që dhanë ndihmesë në organizimin e këtij eventi.

Atmosferën e kësaj feste e ndezi këngëtarja famoze Elda Berisha me këngën "Kuç e zi". Jehona e vargjeve të saj "Ose sot ose kurrë/ na bashkon një flamur/ kuç e zi është Shqipëria/ është Kosova, Çamëria" jehuan fuqishëm grykës së Drinit të Zi e matanë kufirit në trojet shqiptare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Po ashtu edhe vargjet e këngës "Po ku ka si ti moj Shqipëria ime", interpretuar mjeshtrërisht nga vogëlushja Keisiana Duriçi, si dhe Evelina Shabani, mbesë e këtij fshati me zërin e saj brilant në interpretimin e këngëve popullore dibrane. Gjallëri i dhanë festës edhe valltarët e vegjël të Qendrave Kulturorë të Fëmijëve Bulqizë e Durrës, si dhe artistët e mëdhenj të humorit, Mjeshtri i Madh Behar Mera e Genci Lleshi, me interpretimin e disa grimcave humoristike gazmore.

Gëzim, këngë, valle, hare...në këtë natë festive në festën e Viçishtit, fshatit të martirizuar nga pushtues të shumtë dhe nga diktatura komuniste, festë që mbyllet me zërin kushtrimor të Dritan Jasharit në këngën kushtrim "Fluturon shqipja mbi Korab...".



Grëfim krenarisht nga Ida Daci – Abdiu, i dramotragjedisë, që përfshiu dy Dibrat gjatë shekullit 20-të

promovimi

# Edip Daci, akademisti që nuk ju nënshtrua as fashizmit, as komunizmit

HALIL RAMA-MJESHËR I MADH

Ndër 400 studentët shqiptarë që kishin studjuar në Akademinë Militare në Modena të Italisë dhe që refuzuan të bëjnë betimin fashist në Romë 85 vjet më parë, ishte edhe Edip Daci, akademisti, që nuk ju nënshtrua as fashizmit, as komunizmit. Kalvarin e tmerrshëm dhe qëndrësën ndaj pushtuesit, si dhe në burgjet e diktaturës, të këtij pinjulli të një familjeje me tradita të forta patriotike të Dibrës së Madhe, e ka rrëfyer mjeshërisht në një dokumentar televiziv, si dhe në librin e saj "Jetë mes dallgësh", e bija e tij Ida Daci - Abdiu. Dokumentari, si dhe monografia, që u promovuan të martën më 17 shtator 2024 në amfiteatrin e Dibrës së Madhe, prezantojnë në detaje jetën dhe veprimtarinë patriotike të Edip Dacit. Ai nuk e kishte njohur babain e tij Muratin, që si shumë burra të tjerë të kullës së Dacit, e kishte kaluar jetën duke luftuar ndaj shovinistëve serbë. Murati ishte vrarë herët duke lënë jetim 3 djemtë e tij të vegjël, mes tyre edhe Edipin, të cilët do të rriteshin me ndjenja të larta atdhedashurie e do të ecnin në hapat e babait të tyre martir.

E jëma e tij, Fiqirie Daci (Hajdaraga), mbesë e Iljaz pashë Dibrës, edhe pse kishte mbetur vetëm pa të shoqin që në moshën 28 vjeçare, jua kishte kushtuar jetën tre djemve të saj, të cilët do të shkolloheshin e do të hynin me dinjitet në analet e historisë së Shqipërisë, ndër intelektualët më të spikatur shqiptarë të mesit të viteve 1900.

### REFUZIMI PËR TË BËRË BETIMIN FASHIST

"Ishte pragu i Luftës së Dytë Botërore. Shqipëria befasi do të pushtohet nga Italia Fashiste në prillin e vitit 1939. Pikështu në atë kohë, në Modena, Edip Daci dhe gjithë akademistët e tjerë shqiptarë si ai, ishin revoltuar nga akti i pushtimit të vendit të tyre. Të gjithë studentët shqiptarë, pothuajse pa përjashtim, por veçanërisht ata të akademisë që studionte im atë, e pritën me indinjatë dhe me tmerr pushtimin fashist. Nuk dinin se si të shprehnin revoltën në kohën kur autoritetet italiane i morën të 400 studentët dhe nxënës shqiptarë, i çuan në një ambient shumë komod për të bërë betimin fashist në mes të Romës.

U bënë prova mbi 2 javë. I çuan nëpër koncerte, nëpër hotele, nëpër veprimtari, që t'u mbushnin mendjen dhe kështu betimi i tyre do të përforconte atë akt të turpshëm të autoriteteve shqiptare që shkuan dhe zbritën në Bari dhe iu drejtuan Romës me kurorën e Skënderbeut, për t'ia dhuruar Viktor Emanuelit dhe do të përligjte pushtimin fashist. Dhe Shqipëria të bëhej si një pjesë e Italisë. 400 studentët, aty në atë kuadrat edhe im atë, duke qarë, tepër të indinjuar, në 2 javë që iu bënë prova, nuk pipëtinë dhe në momentin kur të gjitha autoritetet italiane ishin rreshtuar në podium dhe admirali do të përmendte betimin italian, e këta do të thoshin: 'betohem', në 400 studentët nuk pipëtiu askush. Asnjëri nuk miratoi dhe nuk u betua nën flamurin italian. Admirali që drejtonte betimin iu kthye autoriteteve dhe tha: këta janë shqiptarë dhe nuk e kanë kuptuar mirë, po e përsëris edhe njëherë. Dhe ndërsa ai kishte nxjerrë shpatën e po përsërste më me forcë betimin nën flamurin italian, përsëri, asnjëri nga 400 studentët, nuk pipëtiu.

Autoritetet italiane u munduan të sfumonin këtë akt heroik të studentëve dhe nxënësve shqiptarë dhe menjëherë futën diçka tjetër për të mos rënë në sy ky skandal që u ndodhi. Një grup të mirë nga studentët, si Skënder Çaçi e shumë e shumë të tjerë, i burgosën, ndërsa këta të tjerët, një pjesë i përjashtuan nga ak-



Edip Murat Daci.

ademia dhe një pjesë i lanë për të mos bërë bujë dhe të mos e popullarizonin këtë akt heroik të studentëve shqiptarë. Një ndër këta studentët, ishte edhe im atë", rrëfen ndër të tjera Ida Daci - Abdiu, në dokumentarin televiziv "Jetë mes dallgësh". Nga ky dokumentar si dhe nga libri i saj me të njëjtin titull mësojmë se pas diplomimit në akademinë ushtarake në Modena, Edip Dacit i ofrohen disa punësi, ndër të cilat mund ta vijonte karrierën e tij ushtarake. E caktojnë fillimisht të inkuadrohej si ushtarak në Abisini, por Edip Daci refuzoi, duke thënë se ai ishte shkolluar për të shërbyer vendit të tij.

### DEZERTIMI NGA LUFTA ITALO-GREKE

"Ne i kemi dhënë fjalën dhe jemi betuar që pas mbarimit të shkollës do t'i shërbejmë atdheut tonë, që sot kur atdheu ynë është i pushtuar nga fashistët, më shumë se kurrë ka nevojë për dijet tona",- mendoi Edip Daci dhe u kthye në atdhe. Në këtë kohë, krahas pushtimit, ekzistonin disa batalione të ushtrisë shqiptare. Edip Dacin e caktuan në një nga këto batalione. Përsëri pushtuesit italianë donin t'i përdornin mish për top oficerët e shkolluar jashtë dhe të parët që i vunë në frontin e parë, në luftën italo-greke, ishin batalionet shqiptare të kryesuar nga Spiro Moisiu, e nga shumë figura të njohura ushtarake, të cilët duke e parë që ata donin patjetër t'i shfrytëzonin këto figura të rëndësishme, jo vetëm që nuk morën pjesë, por sabotuan

• "Pas 11 muaj hetuesi speciale, e çuan me gjithë familjen e tij në një barakë në Bulqizë. Nuk u ofrohej punë as Edipit dhe as Remzies. Ata, me gjithë fëmijët e mitur, duhet t'i bënin ballë jetës së vështirë në atë qytet të vogël të ftohtë, nën survejim të pandërprerë. Ai, akademist me pesë gjuhë të huaja, dilte çdo ditë dhe shiste gështenja që i piqte në një fuçi të prerë përgjysëm dhe gurabijet që ia përgatiste në shtëpi e shoqja. Me ato para do të mbijetonin për ca kohë. Pyetjet munduese për fatin e tij, kishin nisur të shuheshin. E rëndësishme ishte që kishte familjen dhe ishte gjallë. Shokët e tij ishin pushkatuar apo burgosur prej kohësh. Edhe pse rridhte e tillë përmes vështirësive, jeta ishte e vyer dhe ai ja dinte vlerën asaj çfarë kishte"

duke hequr gjilpërat e topave dhe të mitralozëve. Ata dezertuan frontin grek dhe një pjesë iku në drejtim të Korçës e me radhë, ndërsa im atë me batalionin e tij u kthye nga Vlora dhe në Shqipërinë e Mesme, duke ecur në këmbë, të drobitur. Në Shqipërinë e Mesme i arrestojnë dhe i internojnë në kampin e Marikajt, ku e pa veten në listat e antifashistëve më të tërbuar që kishin përpiluar italianët. Pasi lirohet nga kampi i internimit, Edip Daci, dhe shumë ushtarakë të tjerë të diplomuar jashtë si ai dërgohen për pak kohë si pjesë e ushtrisë shqiptare në viset e Kosovës. Të gjithë ata besonin me zemër se Shqipëria enike, ajo ëndërr e kahershme, do të bëhej realitet. Por fatet e vendit të tyre ishin shkruar më herët prej Fuqive të Mëdha e kjo rrugë nuk do të mund të ndryshonte. Kjo u pa qartë në fund të luftës, kur pushtetin e morën komunistët dhe Kosova mbeti në Jugosllavi".

Gjatë viteve të luftës, siç tregon Ida, babai i saj Edipi dhe xhaxhai Vehapi, edhe ai i diplomuar jashtë vendit, kishin mbajtur të njëjtën qëndrim kundërshtues ndaj pushtuesve. Në atë atmosferë të viteve të luftës të dy vëllezërit ishin fejuar dhe kishin ndërtuar familjet e tyre, duke ëndërruar se lufta do të përfundonte e ata do ti shërbenin atdheut.

### ZHËNJIMI NGA PABESIA E REGJIMIT KOMUNIST TË PASLUFTËS

"Pabesia e kohës bëri që i gjithë ky kontribut, e gjithë kjo luftë, i gjithë ky sinjeritet i madh t'u shkojë kot. I vëllai, i përqëndruar me një batalion me ushtrinë shqiptare në Pogradec, bie ndesh me një skuadër partizanë dhe i bën thirrje komandantit: 'jemi shqiptarë, - mos gjuani, jemi batalion shqiptar, jemi ushtarë shqiptarë që luftojmë kundër fashizmit! Por ishte e kotë dhe në momentin e fundit u tha ushtarëve që të iknin, të gjenin një front dhe vetë, vetëflijoi veten, vetëm e vetëm për të dhënë një imazh që nuk duhet të luftohet vëllai me vëllai.

Kjo që disfata e parë që pësoi familja Daci. E ëma, pasi mori vesh këtë vdekje tragjike të djalit, e urdhëroi Edipin: Nuk do ta veshësh më rrobën ushtarake, nuk ka ç'të duhet sepse kjo punë po merr fund, shihet çfarë gjendje është. Asokohe ai kishte kontribuar jashtë mase; në Tiranë kishte një veprimtari me njësitet guerile sepse daja im, Petrit Strazimiri, nga bangat e shkollës shok me Qemal Stafën, lënë bangat e shkollës dhe kalojnë në ilegalitet në Tiranë, duke u ndihmuar edhe nga babai im, shumë. Dhe ai mbeti dëshmor për çlirimin e Kërçovës, ndërsa babi e hoqi rrobën ushtarake duke ia çuar në vend amanetin nënës së vet. U martua me nënën time, nga një familje shumë e fisme, Strazimiri, vajza e një avokati që kishte mbaruar shkollën në Vjenë dhe kishte shërbyer në poste drejtuese të kohës",-tregon Ida. Nga rrëfimi i saj mësojmë se pasi kishte hequr rrobën ushtarake, duke parë situatën që po krijohet, pas martesës, Edipi me familjen

Book cover for 'Jetë mes dallgësh' by IDA DACI ABDIU. The cover features a portrait of Edip Daci in a military uniform and a woman. Text on the cover includes: 'IDA DACI ABDIU ka lindur në qytetin e Bulqizës më 21 shkurt 1954. Arsimin filior dhe Bujtarë e ka kryer në Bulqizë. Arsimin e mesëm e përfundoi në Shkollën e Kulturës në Tiranë, dega e Mësuesisë, 1967 - 1971. Në gusht të vitit 1971 emërohet mësues e mërkurë në shkollën 8 vjeçare "Shoket e Dautit", Bulqizë. Iu shërbën për 10 vite radhazi. Gjatë kësaj periudhe vazhdoi pa ndërprerje puna para studimeve në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, dega Histori - gjeografi, në vitet '72 - '76. Krahas mësimit mbajti angazhimin dhe detyrat veprimtarie kulturore e artistike të rajonit të Bulqizës. Më 1982 transferohet familjareisht në qytetin e Feshkopit dhe emërohet si mësuese historie në shkollën "Domir Gashi". Edhe në këtë shkollë drejtoi me sukses veprimtaritë kulturore e artistike. Në vitin 1990 emërohet përgjegjëse e shërbimit të përgjithshëm "Zaim Shaha", Feshkop. Në maj të vitit 1992 largohet familjareisht nga Feshkopia për në Tiranë ka filluar punë si administratore në qytetin "Studentët" deri kur doli në pension në vitin 2012. ISBN 9789953202117 Çmimi: 1500 lekë BOTIMET M&B



# Edip Daci, akademisti që nuk ju nënshtrua as fashizmit, as komunizmit

(Vijon nga faqja 12)

e tij banonin në një shtëpi të Hafëz Musait. Ai, duke parë inteligjencën dhe përgatitjen e këtij njeriu, ndërjegjen tepër të lartë, e mori dhe i propozoi që ai të jepte teologji dhe frëngjisht në Medresenë e Tiranës.

Fundi i luftës e gjen familjen e re të Edip Dacit në gjendje të vështirë. Të dy burrë e grua, Edipi dhe Remzia, kishin humbur nga një vëlla. Zia kishte pllakosur shtëpinë e tyre. Por ditët e fundit të luftës lajmëronin edhe shumë sfida të tjera që i prisnin.

Filluan reprezaljet e vitit 1944, kur çetat partizane këdo që shikonin dhe që i kishte shërbyer qeverisë paraardhëse, me dhjetëra e mijëra intelektualë i pushkatuan. Në ato kushte, Hafëz Musai, kryemyftiu i republikës, duke parë gjendjen që u krijua në Tiranë, i thotë: Edip, ti duhet të largohesh nga Tirana sa të stabilizohet një çikë gjendja. Nuk po marrim vesh se çfarë po bëhet. Dhe vetë ai e ndihmoi që të ikte nga Tirana, duke marrë një shtëpi me qira në lagjen e Haverikëve në Durrës, ku filloi punë si financier në hotelin "Vollga".

## ARRESTIMI PAS NGJARJES NË AMBASADËN SOVJEKTIKE

Ishin vitet e trazuara 1948, 1949, 1950. I larguar nga Tirana, dhe i zhytur në punën e tij, duke qëndruar larg prozhektorëve, Edipi kërkonte të ngrinte në këmbë familjen e tij të vogël.

Ai ishte patriot dhe si i tillë e shihte familjen e tij të vogël si një potencial të madh për të mbrojtur atdheun e për të punuar për atdheun. Edhe pse regjimi po tregohet i ashpër me të, ai çdo ditë thurte endrra për familjen e tij, e cila do të shtohet në numër e fëmijët e tij do të edukoheshin e do të punonin për vendin e tyre, duke çuar në vend amanetin e të parëve. Por a do të shkonte jeta sipas ëndrrave të tij? Ishte viti 1951. Shkurt. Në Tiranë do të shënohet një ngjarje që do të trondiste opinionin publik. Një ngjarje e inskenuar tek legata Sovjetike do të çonte në pushkatim 21 intelektualë. Kjo ngjarje do të lajmëronte një fat të hidhur edhe për Edipin dhe familjen e tij.

Ida tregon se si një mesnatë, një grup policësh e shqyen derën dhe u hodhën brenda shtëpisë. Ata u ndodhën befasisht përballë tyre, duke e arrestuar Edip Dacin me akuzën absurde "armiku i partisë dhe i popullit".

"Ajo natë nuk do të harrohej kurrë në familjen e Edip Dacit. Ai arrestim do të bëhej shkak për një kalvar të gjatë dhimbjesh e torturash që do e ndiqnin në jetë. E marrin zvarrë tre burra dhe të tjerët vazhdonin të kontrollonin, të shqyenin, të merrnin ç'ka ndodhej në shtëpi. Në fund i erdhi radha bibliotekës të krijuar me aq mund dhe djersë. Të gjithë librat që kishte studiuar në akademi, me të cilët kishte krijuar një bibliotekë, i morën me thasë dhe me krahë.

Në një komo që ndodhej në shtëpi, ishte fotografia e një ushtaraku, ish-student i akademisë militare në Modena të Italisë. Bashkëshortes së tij i afrohet një person nga ata policët dhe i thotë: Hë moj armike, moj borgjeze, edhe fotografinë e Ahmet Zogut e mbani ju në shtëpi?!

Ajo duke u dridhur i thotë: - Jo zotëri.

- Kujt i thua zotëri moj borgjeze. Unë jam punëtor i partisë!

- Është fotografia kur im shoq është diplomuar. Ka qenë student im shoq, çfarë Ahmet Zogu?!

Duke e thyer dhe duke e shkelur me këmbë kornizën, polici e mori me vete fotografinë, për të treguar se çfarë fotografie mbajnë këta në shtëpi. Mendoni çfarë gjendje u krijua. Të nesërmen u mor vesh që 23 intelektualë shqiptarë dhe 200 e ca burra, mos më tepër, ndër ta edhe im atë, përfunduan nëpër birucat e degëve të punëve të brendshme, pas Tiranës edhe rrethe të tjera si Durrësi, Elbasani, Korça etj.

## NJËMBËDHJETË MUAJ HETUESI SPECIALE

"11 muaj hetuesi speciale, 11 muaj, nuk mundem të përmend se të gjithë kemi lexuar, tortura të jashtëzakonshme. Vetëm një refren i ditës ishte për tim atë, edhe i natës, edhe i mesnatës: unë jam Edip Daci, historia e familjes sonë. Ne për këtë atdhe kemi flijuar breza të tërë... dhe i përmendte të gjithë: Ramiz Dacin, që si oficer madhor merr pjesë në të gjithë lëvizjen demokratike krah Isuf Xhelilit, krah Iljaz pashë Qokut, Vehbi Dibrës etj., dhe pati fatin të jetë pjesëmarrës në Shpalljen e Pavarësisë, jo si delegat por si i ftuar. Ai mori pjesë në Kongresin e Lushnjës, një ndër organizatorët dhe përcuesit e të gjitha ideve përparimtare të asaj treve dhe mbarëshqiptare... dhe parardhësit tjerë të Familjes Daci që historikisht kishin treguar vlerat e saj patriotike, liridashëse dhe demokratike, duke u ni-

sur nga stërgjyshërit tanë, duke i përmendur qysh nga Said Daci i vjetër, shok, mik dhe bashkëluftëtar me Abdyl Frashërin; Xhem Daci, Shaqir Daci, si luftëtar i paepur jo vetëm për liri dhe demokraci kundër bullgarëve, turqve dhe më në fund serbëve, por ai ishte një pishtar që jo vetëm mori pjesë në të gjitha kuvendet që u organizuan nën udhëheqjen e Abdyl Frashërit, por ai ishte një ndër kontribuesit më të mëdhenj për hapjen e shkollës së parë shqipe, në gjuhën shqipe, në Dibrën e Madhe...

Unë për këtë atdhe u ktheva nga akademitë, lashë diplomë ndërkombëtare dhe doja t'i shërbeja atdheut tim me dijet e mia. Më keni ngatërruar! Edhe ime më shpresonte se ishte bërë një gabim, se ata ishin njerëz jo vetëm të pafajshëm, ata ishin njerëz që ëndëronin për atdheun, për Shqipërinë e shkatërruar dhe të mjeruar, t'i shërbenin atdheut. Nëna ime ishte motër dëshmori. Por edhe babai im. I vëllai i tij kishte luftuar kundër fashizmit, edhe ai vetë. Nuk e kuptonte se çfarë po bëhej.

Do të kalonte 11 muaj të vështirë në hetuesi. Pushkatimi pa gjyq, i 22 intelektualëve tek ura e Beshirit, kishte çuar shkallën e terroit në pikën më kulminante. Pas një ngjarje të tillë makabre kur sovranit i ishte dhënë grushti i rëndë prej diktatorit, nevojitej një periudhë qetësie dhe zbutje e represionit. Kjo periudhë përkoji me kohën kur Edip Daci mbahej në hetuesi dhe vetëm falë rrethanave historike ai i shpëton pushkatimit", - rrëfen Ida Daci-Abdiu në këtë dokumentar televiziv të realizuar me mjeshtri të rrallë artistike nga gazetarja e mirënjohur Admirina Peçi, dokumentar ky që u ndoq me vëmendje dhe interes të veçantë nga qindra pjesëmarrës, përfaqësues të botës akademike e të letrave.

## AKADEMISTI I MODENAS EDIP DACI NË MINIËRËN E BULQIZËS

"Pas 11 muajve e lirë nga burgu dhe kthehet në shtëpi. Nënës sime nuk i hiqeshin nga sytë rrobat e gjakosura nga torturat dhe nuk po i besohej që ai u kthye gjallë në shtëpi. Mendoni, 11 muaj hetuesi speciale, i tmerruar, i trishtuar, nuk di se si mund t'jua përshkruaj, kthehet në shtëpi duke parë dy fëmijët e vegjël dhe nusën e re. Por kjo qetësi relative u prish shumë shpejt. Me urdhër të prerë, ai duhej të largohej nga Durrësi dhe vendi më i përshtatshëm për të tillë njerëz do të ishte Bulqiza. Babait tim i "dhuruan" kësh-tu Bulqizën. Nuk e njihje atë terren, vetëm kur kishte kaluar nga Tirana në Dibër të Madhe me karvanët e kuajve. E megjithatë, në emër të jetës së dy fëmijëve do të bënte çdo sacrifice. Në një makinë i hodhën plaçkat, dy fëmijët dhe gruan e re dhe u nisën drejt Bulqizës. Ishte dhjetori i vitit 1952. Nëna ime ishte shtatzënë me mua, fëmija i tretë. Dhe unë aty linda", shkruan ndër të tjera Ida Daci (Abdiu) në librin e saj. Është vërtetë tronditës ky rrëfim për jetën e Edip Dacit, ushtarak karriere, diplomuar në akademinë militare në Modena Itali, i cili edhe pse me një varg kontributesh dhe vepra patriotike, nuk i kishte shpëtuar hakmarrjes komuniste. E kishte përfshirë edhe Edip Dacin, vala e tmerrshme spastruese e vitit 1951, në rradhët e intelektualëve shqiptarë.

E çojnë në një familje bulqizake, tepër fisnikë edhe i thonë: për një kohë do banoni këtu, - duke ua hedhur plaçkat nga karrocëria e makinës. Futen brenda të tmerruar, por dashamirësia dhe bujaria e asaj familjeje, e Abedin Duriçit, sikur ua shkriu pak akujt e shpirtit.

Aty gjeti ngrohtësinë dhe besimin sepse paskan ngelur njerëz të mirë prapë, nuk qenkan të gjithë si hetuesit në Durrës, si policët; paska mbetur pak bujari dibrane asaj treve të Bulqizës.

I çuan në atë barakë. Nuk u ofrohej punë as Edipit dhe as Remzies. Ata, me gjithë fëmijët e mitur, duhet t'i bënin ballë jetës së vështirë në atë qytet të vogël të ftohtë, nën survejim të pandërprerë. Ai, akademisti me pesë gjuhë të huaja, dilte çdo ditë dhe shiste gështenja që i piqte në një fuçi të prerë përgjysëm dhe gurabijet që ia përgatiste në shtëpi e shoqja. Me ato para do të mbijetonin për ca kohë. Pyetjet munduese për fatin e tij, kishin nisur të shuheshin. E rëndësishme ishte që kishte familjen dhe ishte gjallë. Shokët e tij ishin pushkatuar apo burgosur prej kohësh. Edhe pse rridhte e tillë përmes vështirësive, jeta ishte e vyer dhe ai ja dinte vlerën asaj çfarë kishte.

Kështu rridhnin ditët në Bulqizë, derisa një ditë dikush ju afrua dhe i kujtoi se sigurimi i shtetit e mban-te nën vëzhgim të rrepte prej kohësh..... Dhe kalvri i strëmundimshëm i kësaj familje do të përfundonte njëherësh me përmbysjen e dikaturës, pas vitit 1990, kur tashmë fëmijët e Edipit qenë promotorë të asaj lëvizje të fuqishme dhe ecën dinjitetshëm, duke ngjitur

Ai, akademisti me pesë gjuhë të huaja, dilte çdo ditë dhe shiste gështenja që i piqte në një fuçi të prerë përgjysëm dhe gurabijet që ia përgatiste në shtëpi e shoqja.



me meritë shkallët e karrierës së tyre, çka do t'i bënte të ndjeheshin krenarë prindërit e shumëvujtur.

## JETA DHE VEPRJA E EDIP DACIT SI TESTAMENT ATDHEDASHURIE

Për autoren e monografisë "Jetë mes dallgësh", Ida Daci - Abdiu, ndonëse personazhet që i japin jetë librit janë të fisit të saj emërndritur, në të përshkruhet me dhimbje dhe krenarisht dramotragjedia, që përfshiu dy Dibrat gjatë shekullit 20-të. Përshkruhet qëndresa e dibranëve ndaj pushtuesve dhe regjimeve të urryera çnjerëzore. Në promovimin e librit, në praninë e qindra përfaqësuesve të elitës dibrane, jo vetëm nga Dibra e Madhe, por edhe nga Tirana e diaspora ajo ndjehej e qetë, sepse kishte përmbushur amanetin e babait të tij, duke e sjellë atë për lexuesin si testament atdhedashurie. "Sot jam e qetë, sepse të gjithë ju në këtë sallë, të tjerë që mungojnë, të gjitha përkatësitë e ndjeshmëritë e ndryshme, konvergojnë në një pikë të vetme: distancimi e dënimi i shovinizmit e totalitarizmit, si dhe në përpjekjet e përbashkëta për të mbrojtur liritë dhe të drejtat themelore të njeriut; në përpjekjet që e gjithë Dibra, ajo e Poshtme dhe ajo e Epërme, si pjesë të qenësishme të kombit shqiptar, të tejkalojnë urrejtjet e ndasitë dhe të ndihmojnë në udhëtimin tonë të përbashkët rajonal drejt strukturave euroatlantike", tha ndër të tjera Ida Daci-Abdiu. Librin "Jetë mes dallgësh", si dhe dokumentarin përkatës televiziv ajo i konsideron homazh për prindërit, Edip Daci dhe Remzie Strazimiri-Daci, që i rritën me aq shumë mundime, por që s'mundën të rikthehen në Dibër e tyre të dashur.

Në këtë veprimtari promovuese mbresëlënëse, të moderuar mjeshtrisht nga Mjeshtri i Madh Defrim Methasani, vlerat dhe mesazhet që përcell ky libër u evidentuan nga redaktori i tij Lavdrim Shehu si dhe nga akademiku Adem Bunguri, ndërkohë që përshëndetën edhe ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese Fehmi Abdiu (kunat i autores), Prefekti i Dibrës Nexhbedin Shehu, kryetari i Komunës Dibër e Madhe, Dr. Hekuran Duka, ish kryebashkiakët e Peshkopisë dhe Bulqizës, Ilir Krosi e Roland Keta, etj.

"Në të gjitha faqet e librit, (si edhe në dokumentarin televiziv) autorja, duke u shprehur në vetën e parë, shfaqet tokësore, humane dhe pagabueshmërisht e vërtetë....Duke na dhënë një pasqyrë të jetës njerëzore për gjatë gjithë shekullit 20-të, ashtu si shkëmbenjtë që mbeten të egër e të fortë, të palëvizshëm e të pandryshueshëm, në çdo detaj para syve të lotit, ashtu do të qëndrojnë e vërteta e Idës, kryelartë e krenare përpara epimit të kohës, që ka ndryshuar e do të ndryshojë vazhdimisht", tha ndër të tjera redaktori i librit Lavdrim Shehu.

Pjesëmarrësit pritën gjithashtu me ovacione "Mirënjohjen" që kryetari i Shoqatës Atdhetare Bulqiza, Bashkim Lami, i akordoi Edip Murat Dacit (pas vdekjes) në emër të kësaj shoqate, me motivacionin: "Mirënjohje për këtë bir të familjes patriotike DACI, nga Dibra e Madhe, që në disa breza luftuan e sakrifkuan për Atdheun në luftë e në politikë, të përballur me kalvarin e dhimbshëm të disa bijve. Intelektual i shquar, akademisti ushtarak shembullor në Modena e kundërshtar i fashizmit. Mirënjohje e vlerësim për jetën me sakrificë të mëdha të tij dhe familjes, që nuk iu nënshtrua as fashizmit e as komunizmit, duke u përballur me diktaturat me trimëri e burrëri. Qytetar e prind shembullor që rriti dhe edukoi me sakrificë fëmijët në Bulqizë, duke mbajtur lart dashurinë për punën, jetën e Atdheun".



Mijëra shqiptarë që mbushën sheshin "Iliria" të Tetovës festojnë fitoren e 24-t në kikkoks dhe boxing të kampioni shqiptaro - euroaziatik

# Rikthim pas 6 vitesh me fitore i "Tajsonit shqiptar" Gjetan Keta

- **Është rast i rrallë, ndoshta unikal në historinë e sportit, që nga e njëjta familje të dalin tre kampionë botërorë. Ata janë Ismail, Gjetan dhe Ferit Keta, tre vëllezër kampionë bote në sportin e kikkoksit dhe boksit**

Nëzetë e katër fitore në 27 ndeshje në kikkoks dhe boxing (20 me KO), e rendisin me më të mirët e botës në këto sporte. I rikthyer pas 6 vitesh mungesë "Tajsoni i bardhë", kampioni shqiptaro - euroaziatik Mike Gjetan Keta, kur-rësesi nuk do t'i zhgënjente mijëra tifozët që ndoqën ndeshjen e tij të radhës të shtunën e 27 korrikut në Tetovë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kjo për faktin se në arenën e ringut, Ai fitoi që në raundin e parë me nokout përballë kolumbianit Jose Miguel Torres. Në fund të mbrëmjes gala kur në sheshin "Iliria" të qytetit të Tetovës ishte rezervuar ndeshja më e rëndësishme, pikërisht pa përfunduar minuta e dytë e ndeshjes, në raundin e parë (1.59") kampioni Keta e goditi në ije kundërshtarit Torres që ngeli KO dhe nuk u ngrit më, duke ngritur kështu peshë mijëra tifozët e tij.

Kjo fitore e shkëlqyer vjen pas 6 vite pauze, pas një dëmtimi në krahun e majtë, në një atmosferë feste madhështore që u krijua në sheshin "Iliria" të Tetovës nga shqiptarët dhe flamujt kuq dhe zi.

"Një raund mjaftoi për kampionin e Europës Gjetan Keta të fitonte me KO ndeshjen e madhe të boksit në Tetovë përballë kolumbianit Torres. Pas gjashtë vitesh ai rikthehet në ring dhe risjell fitoren e bukur të tij. Faleminderit kampion për emocionet dhe fitoren me ngjyrat kuqezi! Rrugëtimi i dinastisë Keta vazhdon", shprehet Mjeshtri i Madh Defrim Methasani, ndër gazetarët sportiv dhe moderatorët më të mirë në rang kombëtar, i cili prej



ditësh i parapriu kësaj fitoreje, jo vetëm me sensibilizimin e opinionit sportiv, por edhe me mbështetje reale ndaj bulqizakut "Qytetar Nderi" i Bashkisë Bulqizë - kampion Europe, që për këdo konsiderohet krenari kombëtare.

Një rikthim trimfal ky, i Mike Gjetan Keta, fitues i titullit kampion Europe në kikkoks dhe boks në Tiranë që në vitin 2007. Gjashtë vite më parë në 2018 ai qe sërish fitues në ndeshjen në Dibër të Madhe, fitore kjo që entuziazmoi edhe këngëtarin famoz Aurela Gaçe, e cila ngriti peshë zemrat e dibranëve me performancën e shkëlqyer në interpretimin e këngës epike dibrane "Hajredin Pasha po vjen Radikës".


Vellezerit Keta, nga Bulqiza vijojne te na bëjnë krenar kudo nëpër botë. Ismail, Gjetan dhe Ferit Keta, kikkoksier dhe boksier kampionë bote e Europe, janë kampionë në sport dhe filantropi.

Njeriu, në jetë, arrin atë që beson më shumë. Kështu ka ndodhur me Ismail Ketën, tre herë kampion bote në kikkoks: më 2011, 2012 dhe 2013. Ai tani është pedagog, mjeshtër, për studentët e tij. Ai e filloi karrierën e tij si një boksier amator. Politikanët dhe njerëzit e biznesit e punësuan atë si një trupprojë. Në moshën 19 vjeç, ai u largua nga Shqipëria për të ushtruar sportin. Në 1997, Ismail Keta "Demi" u shpërngul në Würzburg ku ai filloi karrierën si një boksier amator dhe më pas korri sukses.

Gjetan Keta është një boksier profesionist shqiptar që ndeshet për peshat e mesme. Ai u trajnua nga vëllai i tij Ismail Keta, që ishte një kikkoksier profesionist. Ai ka realizuar 27 ndeshje, 24 fitore dhe 4 humbje. Në 2014, Keta shprehu dëshirën për të realizuar një ndeshje në vendlindjen e tij, në Bulqizë. U njoftua se ai do të mbronte titullin e tij euroaziatik në kampionatin e boksit për peshat e mesme kundër boksierit rus, Marat Khuzeev në 18 tetor 2014 në Bulqizë. Aty, Keta e mundi Khuzeev me "knockout" në raundin e tretë.

Ndonëse 40 vjeç, Gjetani është rast i rrallë e ndoshta unikal. Ai do vazhdojë karrierën sportive. Në bisedë me të na pohon se ka kërkesa edhe nga promotorë të boksit në Angli për të bërë një ndeshje në Londër

Është rast i rrallë, ndoshta unikal në historinë e sportit, që nga e njëjta familje të dalin tre kampionë botërorë. Ata janë Ismail, Gjetan dhe Ferit Keta, tre vëllezër kampionë bote dhe Europe në sportin e kikkoksit dhe boksit. U rritën me lavdinë e kombit, tani kombi lartësohet me lavdinë e tyre. Të tre vëllezërit e dinastisë Keta nga Bulqiza, me një histori të interesante edukimi dhe rritjeje. Karshi fshatit Koçaj, vendlindjes së tyre, vendi i luftërave legjendare të Skënderbeut, do të ishte modeli mentor udhëheqës në koshiencën e kampionëve botërorë.



## Adriatik Cami - Kampioni sportist dhe njeri, "Ambasador për Paqe"

**Sportistët e formatit të tij janë ambasadorët më të mirë të Shqipërisë në botë**

Të dielën e 14 prillit 2024 Adriatik Cami - "kampioni sportist dhe njeri", siç e vlerëson ikona e gazetarisë sportive dhe e dokumentarit televiziv Defrim Methasani, ka përjetuar një moment sa të bukur aq edhe emocionues, duke u nderuar me dy tituj që shpërblejnë kontributin e tij

- **Djaloshi dibran Adriatik Cami - kampion bote në kategoritë ËKF dhe ËIPU në sportin e kikkoks-it, sportist dhe trajner model, një pasionant dhe djalë luftarak që falë punës së tij arriti të ngjitej si kampion në majat e federatave europiane dhe botërore në kikkoks, prej 28 vitesh jeton e punon në Athinë, ku ka ndër-tuar familjen e tij të mrekullueshme. Ai ka fituar zemrat e jo vetëm të shqiptarëve të Pireut, por edhe të grekëve, madje prefekti i Pireut kish deklaruar se nëse do të kishim 2-3 Adriatik të tjerë, Pireu dhe Athina do të ishin ndryshe**

në tre dekada, në sport dhe të një jete aktive sportive në Athinë. Federata e Paqes Universale e Shqipërisë, i akordoi, krahas 10 personaliteteve që jetojnë në Greqi, titullin "Ambasador për Paqe", ndërsa Unioni i Gazetarëve Sportivë të Shqipërisë, titullin e Mirënjohjes.

"I lumtur që këtë titull ma dorëzoi ish futbollisti i Flamurtarit dhe Kombëtares, Ambasadori për Paqe Kreshnik Çipi, në prani edhe të Ambasadores sonë në Greqi Luella Hajdaraga dhe Zv ministres së jashtme zonjës Artemisa Malo", shkruan Cami në faqen e tij në facebook, ndërsa ka falenderuar edhe Kryetaren e FPU të Shqipërisë Eva Çipi, Sekretarin e Përgjithshëm Gani Rroshi, Kryetarin e Këshillit të Paqes Tiranë Defrim Methasani dhe kordinatorin e këshillit të Paqes Sarandë në Athinë Anastas Murati.

Padyshim që këto tituj janë një gëzim për momentin, por edhe një përgjegjësi për të ardhmen, për të fituar më shumë tituj kampion e medalje me sportistët që Adriatik Cami po përgatit në boks dhe kikkoks, por dhe për të qënë një familjar i mirë e qytetar dinjitoz.

Ndërkohë, Defrim Methasani - Mjeshtri i Madh nuk e fsheh krenarinë që ju dha mundësia të moderojë ceremoninë lauruese për 10 personalitete shqiptare të cilët jetojnë në Greqi.

Mes tyre ishte përzgjedhur sportisti dhe trajneri model Adriatik Cami, një pasionant dhe djalë luftarak që falë punës së tij arriti të ngjitej si kampion në majat e federatave europiane dhe botërore në kikkoks. Adriatik Cami është shpallur kampion bote në kategoritë ËKF dhe ËIPU në sportin e kikkoks-it.

Para pesë vjetësh ka marrë titullin "Qytetar Nderi i Bulqizes" nga Këshilli Bashkiak i këtij qyteti, duke u vlerësuar si krenari dibrane e mbarëshqiptare.

Djaloshi dibran që prej 28 vitesh jeton e punon në Athinë, ku ka ndër-tuar familjen e tij të mrekullueshme, ka fituar edhe zemrat, jo vetëm të shqiptarëve të Pireut, por edhe të grekëve, madje prefekti i Pireut kishte deklaruar se "nëse do të kishim 2-3 Adriatik të tjerë, Pireu dhe Athina do të ishin ndryshe".

Natyrisht që kampioni Cami ndjehet krenarë për një vlerësim të tillë dhe të dy titujt që iu dhanë "Ambasadorë për Paqen" dhe "Mirënjohje" nga UGSSH, tituj që iu dorëzuan nga Mjeshtri i Madh Kreshnik Çipi, që natyrisht janë të merituar për këtë sportist kampion dhe njeri po të tillë.

Kampioni botëror në kikkboxing, Adriatik Cami mbetet gjithmonë frymëzues për brezat e rinj. Sportistët e formatit të tij janë ambasadorët më të mirë të Shqipërisë në botë.



# Kënga e Dibrës kundër Hajredin Pashës, mbledhur nga Haki Stërmilli ...dhe një fakt me vlerë se si Mid'hat Frashëri këshillon Stërmillin të ruajë dialektin e Dibrës

Haki Stërmilli, shkrimtar, atdhetar e luftëtar i paepur për lirinë e Shqipërisë, dëshmohej të jetë një pasionant i madh i folklorit, siç e dëshmon botimi i vitit 1944 në vëllimin XIV, "Fyelli i Dibrës", botuar në "Visaret e Kombit", nga shtypshkronja "Gurakuqi", në Tiranë. Natyrisht, këngët janë mbledhur shumë vite më përpara, gjatë kohës së mbretërisë, ndoshta edhe nga autorë të ndryshëm, por merita e Stërmillit është se i ka përmbledhur dhe botuar këto këngë. Madje, në hyrjen e librit, Haki Stërmilli na kujton se këngët ia ka marrë kushëritit të tij Musa Stërmilli, që në atë periudhë ishte 75 vjeç, por me kujtesë të shkëlqyer.

"Veç kësaj, me qëllim që në të ardhmen të vlejë si dokument studimi për kompetentët, u mundova ta riej, besnikisht, fonetikën dhe dialektin e Dibrës, punë për të cilën më këshilloi edhe z. Midhat Frashëri e z. Gjergj Kokoshi", shkruan Stërmilli në parathënien e librit që e ka botuar Ministria e Arsimet e kohës.

Në një postim të mëparshëm ne ju njohëm me këngët e Sheh Fejzës dhe Dalip Karajt nga Bulqiza, këngë që përkohë me ngjarjet historike të vitit 1860 dhe 1872, respektivisht kundër Avdi Pashës e Demir Pashës. Sot po ju njohim me një nga këngët himn të Dibrës, kënga e Maleve të Dibrës në luftë me Hajredin Pashën, këngë që këndohet edhe sot me të njëjtin pathos. Ne po e paraqesim këtë këngë në versionin original të Haki Stërmillit, që është një version i dialekteve të Dibrës (ndoshta Dibra e Madhe, ndoshta Peshkopia, le ta gjykojë secili me vetveten). Stërmilli thotë se Hajredin Pasha shkeli në Dibër në vitin 1840 me 60 mijë ushtarë (sipas këngës), por ne e dimë tashmë se ngjarja ka ndod-



hur në vitin 1844 dhe Hajredin Pasha ka hyrë në Dibër, në betejën e Gjoricës, me 12 mijë ushtarë.

## LUFTA E DIBRËS KUNDËR TURQISË

Hajredin Pasha po vjen Radikës, Pejt(1) ku jon malet e Dibrës. Vall ku jon malet e Dibrës? Bojn xhilis(2) në foush të Gjoricës. Bojn xhilis e lidhin besën Çi Hajredin Pashën do t'a presin Moj Gjoricë, moj kasaba, Çon pasha e të bon rixha; Po rixhaja s'ju ka digju, I thkej(3) topat me luftu,

Sheh Zerqani fjalë ka çou: Thoj Kaloshit me na ndihmou. Grik'n e Madhe e kan rrethou; Për rreth Drinit tu luftou. Për rreth Drinit tu luftou, Ximxa(4) mbet e ximca pjagou,. Mustaf Jakini musteqe bardhë Boni irish(5) e zou në Dardhë: Hiçu Pashë se të kom falë Kom kuvend me Mirallajnë. Ditën e Martë u zou nizaja(6), Hajredin pashën e xhet belaja; E xhet belaja ç'i e ka xhetë, Shtatë taboret i jon shkretë; Nandëmij vorret kush i boni? Të Nand Malet e Sheh Zerqani; Rizvan Halla me at sokore S'po pushon tue bomun vore; Kush ja prejshi fesin Pashës? Fazli Malja e Plaku i Krajkës.

## FJALORTH

- 1.pejt=pyet
  - 2.xhilis=mexhlis=kuvend
  - 3.thkej=kthej, ktheu
  - 4.ximxa=gjysma
  - 5.irish=perpara, sulm
  - 6.nizaja=grindje
  - 7.kosore=cakorre=sëpatë e vogël
  - 8.fesin=qeleshen=plisin
- Florian Fusha, faleminderit qe e mundesuat ne-permjet librit te gjetur prej jush kete informacion me vlere!

(Nga faqja e Dr.Adriatik Balla në facebook)



DR. ADRIATIK BALLA

(Mbeshtetur ne qendresen e Bulqizes ne luften e viteve 1912-1921)

1. Kur të flasim për luftën e Dibrës, e nëntë vjet betejë me Krajl, s'harrohet, jo, roli i Bulqizës, dhe burri i maleve në Vajkal.
2. Shpirt njeriu ish Mehmet Duriçi, trim si ai nuk bën ma nana, kish thith ajër nga Muriqi, zëri i tij porsu kambana.
3. Në luftë me turkun peseqind vjet, për të ardhur tek pavarësia, amaneti kurrë s'ish tret, derisa mbërriti e ëmblë liria.



MEHMET DURIÇI

4. Festa e fitores nuk ish shijuar, armiq të rinj erdhën tek dera vranë e prenë, duke dhunuar Shqipëria, ç'hoq e mjera!
5. Gjithë Dibra u ngrit në këmbë, me grusht e zjarr e priti dushmanin, luftoi ajo dhëmbë për dhëmbë me serbin gjaksor, si shejtanin.
6. Krahinat të gjitha u bënë bashkë, me besa-besë për të shpëtuar, katundet digjeshin porsu ashkë, por, asnjëherë të dorëzuar.
7. Kur serbët mësynë në luginë, dogjën, prenë e masakruan,

## Elegji për Mehmet Duriçin

- shumë fëmijë i lanë jetimë, me qindra vranë e torturuan,
8. U mblodhën burrat vullnetarë, të lidhur n'besë e dorë për dorë. u lutën që punët të shkojnë mbarë, spikatën udhëheqësit popullorë.
9. Mblidhen krerët në kuvend, n'kullë t'Mehmetit rrëzë Dhoksit, diskutojnë e bëjnë mend, me të madhe i bien gjoksit.
10. Mehmeti foli e u tërbue, disa rrugën paskan tradhtue, "Për Shqipërinë kush s'do me luftu, ta dijë mirë, ka punë me mu".
11. Por fjalën dikush ia preu, ish nga Sillova, Elez Ndreu, "sa të jemi gjallë, Mehmet o vlla, Dibërën s'e lshojmë me gjak pa u la".
12. Në fjalë ftuan Bajram Currin, këtë kreshnik të Malësisë, në gjunjë u ulën, puthën flamurin, si lanë gjë mangët historisë.
13. Mehmeti organizoi Bulqizën, mbrojtjes me shpirt iu përkushtua, tradhtarëve u hoqi "vizën", ndër beteja, fitimtar u dallua.
14. Çeta e tij me njëqind vetë, për serb katilët u bë tmerr, shumë trima e paguan me jetë, por armiqtë i çuan në ferr.
15. Duke ardhur anës fushës, i goditi tek kulla e Muçës, Porsa ish çel gjethe i lisit, i goditi tek kulla e Licit.
16. E mbajti premtimin e Babës, u hakmor për kullën e Shabës. Shtegun e lirisë i tregoi miletit, dogji karakollin në Urë t'Qytetit.
17. Kudo shkeli këmbë e tija, mjaltë e ëmbël vinte lirija. luftoi me kraja, u bëri ballë halleve, Mehmet Duriçi, Burri i Maleve.
18. Bulqizës i la një amanet, që as dheu nuk e tret, "Po të rrini të bashkuar, askush s'ka për t'ju dhunuar"!

**Shënim:** Gjatë viteve 1912-1921, për plot 9 vjet, krahina e Dibrës përjetoi tmerre të mëdha nga pushtues të huaj, kryesisht serbët, të cilëve Dibra iu përgjigj me armë. Në këtë luftë krejtësisht të pabarabartë me armatën serbe, spikati organizimi popullor dhe udhëheqësit lokalë, të cilët vuajtën shumë por ia dolën të ruanin brenda Shqipërisë politike atdheun e tyre. Në këtë luftë, sikurse çdo krahinë, dha një kontribut të rëndësishëm edhe Bulqiza, e cila kishte organizimin e saj dhe udhëheqës i çetës vullnetare të Bulqizës ka qenë Mehmet Duriçi, burrë patriot, i vendosur, dhe të cilin kjo luftë e evidentoi si një strateg dhe udhëheqës i Bulqizës e më gjërë në ato vite.



Është një investim që do i shërbejë perspektivës, duke ulur në maksimum shpenzimin e energjisë elektrike.




# REVOLUCION TEKNOLOGJIK NË FABRIKËN E PASURIMIT TË KROMIT

rreth 33% te konsumit vjetor.

Është një investim që do i shërbejë perspektivës, duke ulur në maksimum shpenzimin e energjisë elektrike.

Ing.Bukurosh Koçi, të cilit në vitin 1980 i refuzohej e drejta e studimeve të larta për "njolla në biografi" sot është ndër sipërmarrësit më të suksesshëm në rang vendi. Ai është autor i disa studimeve



**N**ë Fabrikën e Pasurimit të Kromit Bulqizë, është realizuar një "revolucion teknologjik". Pasi ka sjellë dhe implementuar teknologjitë më të përparuara botërore në mjediset e fabrikës, Administratori i saj, Ing. Bukurosh Koçi, realizoi një tjetër investim madhor. Projekti i impiantit fotovoltaik me kapacitet 1000 KW/h konsiston në instalimin e paneleve diellore, për realizimin e të cilit u investuan 840 mijë euro.

Ky impiant I instalur që në janar 2024 ka ndikuar në uljen e kostos së konsumit të



energjisë elektrike duke prodhuar 1 megavat në vit ose

të kryera për pasurimin dhe parapasurimin e mineraleve

të kromit në zonën e Bulqizës, Batrës, Krastës, Tërrnovës, Kukësit, Tropojës, Hasit etj, si dhe bashkpunëtor në kryerjen e disa studimeve nga

Instituti i Studimeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë. Qe ne janar eshte montuar impianti fotovoltaik me kapacitet \_\_\_\_\_ ,

**SHOQATA BULQIZA**  
**Atdhetare Kulturore**

**"MOS PYET SE ÇFARË MUND TË BËJË BULQIZA PËR TY, POR PYET SE Ç'MUND TË BËJSH TI PËR BULQIZËN."**

